



Buletini i Austria Praemix

Kategoria: Të imta

Përmbajtja

1. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË REZULTATET E MBARËSHTIMIT TË TË IMTAVE DHE TË TË DHIRTAVE.....	3
2. SI DALLOHET CILËSIA E MISHIT TË QENGJIT	6
3. MË SHUMË PROFESIONALIZËM NË MBARËSHTIMIN E TË IMTAVE	9
4. PRODUKTET E QUMËSHTIT TË DELES - NË TRENDIN E KOHËS	11
5. TË USHQYERIT E DELEVE DHE MBARËSHTIMI I QENGJAVE	12
6. TË USHQYERIT E TË IMTAVE	13
7. MBARËSHTIMI DHE TË USHQYERITTE TË DHIRTAT.....	16
8. TË USHQYERIT E DHIVE NËLAKTACION	19
9. MILLAPHOS—KONCEPTI MË I SUKSESSHËM I TË USHQYERIT NGA SCHAUMANN	23
10.DHITË: KUJDESI PËR KAFSHËT	24
11.SEZONI I MBARËSHTIMIT ËSHTË AFË R.....	27
12.MENAXHIMI I KULLOTAVE KUNDËR NDIKIMIT TË PARAZITËVE	29
13.SA USHQIM KONCENTRAT NEVOJITET PËR MAJMËRINË E KECAVE?.....	30
14.VITAMINA- AS SHUMË, AS PAK	32
15.DELET DHE QENGJAT- Informacione profesionale të përgjithshme.....	34
16.KARAKTERISTIKAT E USHQYERJES SË DHIVE TË QUMËSHTIT	38
17.QUMËSHTI I SË ARDHMES VJEN NGA DHIA.....	42
18.TË USHQYERIT E DELEVE ME VITAMINA DHE LËNDË MINERALE ME DREJTIM PRODHIMIN.....	47
19.PËRFITIMI EKONOMIK NGA MBARËSHTIMI I DELEVE.....	50
20.VLERËSIMI I KARAKTERISTIKAVE TË MBARËSHTIMIT TË DELEVE DHE DHIVE	53
21.INFORMACIONE INTERESANTE RRETH DELEVE DHE DHIVE Përpunuar nga Jon Zeneli	56
22.RACAT E DELEVE DHE DHIVE PËR PRODHIMIN E QUMËSHTIT	58
23.MISHI I QENGJIT - MË E MIRA E NATYRËS NGA FERMAT LOKALE.....	62
24.MISHI I QENGJIT - KËSHILLA TË DOBISHME	63
25.MISHI I QENGJIT - KËSHILLA PËR GATIM	65
26.QUMËSHTI I DELES DHE I DHISË NË DIETËN USHQIMORE	67
27.PËRPUNIMI I QUMËSHTIT NË FERMË.....	70
28.RECETA ME DJATHË DELEJE DHE DHIE	72
29.PRODUKTE CILËSORE TË DELEVE DHE DHIVE	74
30.KÄSEMACHERWELT - BOTA E PRODHIMIT TË DJATHIT-.....	75
31.FERMA E DHIVE MANDL.....	76

1. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË REZULTATET E MBARËSHIMIT TË TË IMTAVE DHE TË TË DHIRTAVE

Përpunuar nga Kristian Maka

Rezultatet e mbarështimit	
Fertiliteti	Humbjet e qengjave dhe kecape
Gjenetika	Të ushqyerit
Rritja	Rritja
Menaxhimi	Higjena
Shëndeti	Shëndeti
	Vitaliteti

Fertiliteti i deleve dhe dhive ndikohet nga disa parametra:

- ♦ Gjenetika: Supozohet se fertiliteti përcaktohet gjenetikisht vetëm në një masë të vogël.
- ♦ Të ushqyerit: Duhet të përshtatet në mënyrë optimale me nivelin e performancës dhe nevojave të kafshëve; furnizim me minerale dhe vitamina.
- ♦ Rritja: Nevojiten kushte optimale të mbarështimit të kafshëve.
- ♦ Menaxhimi dhe shëndeti i kafshëve: Sa më shpejt të jetë e mundur përdorimi i kulloshtrës.

Në Evropën Qendrore tregu përcakton mënyrën e mbarështimit dhe rritjes së kafshëve.

Ligji për tregun:

- ♦ "Mallrat e këqija të cilat marketohen mirë shiten vetëm një herë"
- ♦ "Mallrat e mira me marketing të mirë shiten gjithmonë"

Përzgjedhja:

- ♦ Pjellori e lartë (3 qengja në vit)
- ♦ Kafshë me strukturë të mirë trupore
- ♦ Kafshë jo të dhjamosura

Këshilla praktike: Dehmetizimi (të paktën 2 herë në vit, sugjerohet 4 herë në varësi të klimës dhe vendit ku mbarështohen kafshët), qethja, shkëputja e hershme e qengjave.

Mbarështimi i deleve dhe i dhive:

- ♦ Blerja e kafshëve
- ♦ Pedigreja e kafshëve (racat, kryqëzimet)
- ♦ Kushtet e mbarështimit
- ♦ Të ushqyerit (ushqyerja e deleve në bazë të performancës, aktiviteti i dashit)
- ♦ Të ushqyerit e qengjave dhe kecape, përbërja e ushqimit të koncentruar,
- ♦ Të ushqyerit e deleve dhe dhive të qumështit)
- ♦ Shkëputja nga nëna
- ♦ Shëndeti (shtatzënia, periudha e të ushqyerit të qengjave dhe kecape me gji)
- ♦ Kontrolli i parazitëve, kujdesi për kullotat, sëmundjet infektive)

Prodhimi i mishit të qengjave

- ♦ Fertilitet i lartë
- ♦ Lindja e qengjave çdo 7 muaj
- ♦ Fitime të larta ditore
- ♦ Konsum i vogël i ushqimit
- ♦ Jetëgjatësi
- ♦ Kapacitet të lartë të prodhimit të mishit
- ♦ Cilësia e mirë e karkasave
- ♦ Rendiment i lartë i therjes
- ♦ Mish me pak dhjamë


Konsiderata ekonomike - planifikimi i orientimit të biznesit në të ardhmen

- ♦ Përcaktimi i pikave kryesore të dëshiruara
- ♦ Më pak punë
- ♦ Cilësi më të mirë jete, më shumë kohë të lirë
- ♦ Më shumë kohë për familjen
- ♦ Pak investim
- ♦ Njohuritë teknike të lehta për t'u mësuar
- ♦ Menaxhim i lehtë dhe më shumë të ardhura
- ♦ Prodhimi i produkteve të gatshme
- ♦ Qumështi dhe produktet e djathit – marketing direkt
- ♦ Vlerë e lartë e shtuar
- ♦ Mundësia e blerjes së plotë, me 10 hektarë tokë kullotë

VENDIMMARRJA

Prodhimi i mishit

Përfaqësuesit e racave të mishit: Merinos



1. Kofsha
2. Kurri
3. Shpatulla
4. Gjoksi dhe barku
5. Koka, qafa

Prodhimi i qumështit

Dele qumështi



Mbarështimi

Kujdesi ndaj natyrës

Më e mira vjen nga natyra:

- Heidschnucke
- Zackelschaf



Delet e qumështit

Mbarështuesi modern dhe progresiv i deleve preferon raca të fuqishme, fisnike dhe inteligjente, të cilat kanë pjellori të lartë dhe rendimentit maksimal të qumështit.

Qumësht + specialitete

Qumështi i deles është një ushqim me vlera dhe po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për shkak të tendencës së re në kuzhinën moderne: të shëndetshme, natyrale, me vlera dhe të shijshme. Një ilaç "ushqimor" – gjithashtu me efekte mjekësore të vërtetuara!

Specialitetet e qumështit të deles po pushtojnë menunë, jo vetëm në kuzhinën lokale, por edhe atë evropiane. Mishi i qengjave të qumështit është një specialitet për çdo menu dhe ka gjetur vend dhe në dieta tëaktuara.

Përfitimet nga delet Merino

- Cilësi të mira mëmësore (qengja gjatë gjithë vitit).
- Lindje me më shumë se 1 qengj
- Karakteristika të mira të majmërisë
- Pak probleme të gjirit
- Pak probleme me lindjen (pak qengja mbipeshë)
- Dele të këndshme dhe të qeta
- Sjellje e mirë në tufë
- Me rendiment të lartë (kur ushqehen mirë) dhe jetëgjata
- Dele të fuqishme (pozitive për tufa të mëdha)

Kërkesa bazë për një mbarështim të suksesshëm

Kafshët, pavarësisht nga raca, përveç shëndetit duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

- Fertilitet i lartë: lindje kryesisht të shumëfishta Gatishmëria për t'u çiftëzuar gjatë gjithë vitit: furnizim i vazhdueshëm me qengja për therje
- Karakteristika të mira majmërie: fitime të larta ditore, konsum i ulët i ushqimit
- Lehtësi në pjellje: nuk ka nevojë për obstetrikë

Meshkujt e tufës:

- * Kondicion i mirë trupor
- * Aktivitet seksual: kërkim intensiv dhe kërcim mbi delet
- * Aftësi e larte fekonduese

PERFORMANCA:

Pjelloria, e cila shprehet në numrin e qengjave për lindje, është baza më e rëndësishme e suksesit. Ajo varet nga:

- Të ushqyerit, veçanërisht para dhe gjatë sezonit të çiftëzimit (më shumë energji dhe proteinë),
 - Në sezon: pjellja pranverore zakonisht rezulton në një rezultat 10-20% më të lartë të pjelljes,
- Rritja: p.sh. shmangia e situatave stresuese, gjendja shëndetësore e tufës,
- Pasardhësit duhet të vijnë nga nëna pjellore mbi mesataren - merrni parasysh lindjet e shumëfishta, Nga numri i deleve/dash: rekomandohet një dash për 30 deri në 50 dele

Shembuj përzierje ushqimi për majmërinë e qengjit

Kg Foragjere / në ditë	Lloji i foragjereve	Përmbajtja e proteinave të papërpunuara në
0,2 kg	Kashtë	18,0%
0,3 kg	Sanë	17,0%
1,0 kg	Silazh bari – Kos e parë	16,5%
1,0 kg	Silazh bari – Kos e tretë	16,0%

Komponentet	Varianti A	Varianti B	Varianti C
Soja 44	25,0	12,0	-
Bizele	-	12,0	30,0
Bërsi Kolze	-	12,0	20,0
Elb	24,5	18,4	20,0
Misri	25,0	20,0	10,0
Bërsi Panxhari	20,0	20,0	1,5,5
Ushqime mineral	1,5	1,5	1,5
Lëndë Minerale	2,0	2,1	2,5
Kripë	1,0	1,0	1,0
Vaj kolze	1,0	1,0	1,0

Përbërësit

MJ/ME	11,1	11,1	11,0
RP in g	178	177	179
RP : MJ	16,0:1	16,0:1	16,2:1
Rfa in g	72	80	81
Ca in g	13,2	14,1	15,4
P in g	4,1	4,7	5,2
Na in g	5,6	5,6	5,4
Ca : P	3,2 : 1	3,0 : 1	3,0 : 1

2. Dele me rendiment të lartë – Qumështi i deles dhe specialitetet e djathit

Djathë deleje:

- ♦ i freskët – natyral – i shëndetshëm
- ♦ Shije e veçantë
- ♦ I preferueshëm nga shumica
- ♦ Biodiversiteti kërkon kreativitet
- ♦ Ofertë e paktë në treg
- ♦ Nuk ka presion nga importi
- ♦ Cmime të larta
- ♦ Zëvendësues për alergjikët ndaj qumështit të lopës



Përfitimet e shkëputjes së hershme nga gjiri:

- ♦ Mundësi më të pakta të infektimit nga parazitët e brendshëm (më pak mjekim)
- ♦ Ulja e rrezikut të lëndimeve të gjirit (infeksionet infektive të gjirit)
- ♦ Rritja e prodhimit të mishit
- ♦ Qengjat e shkëputur nga gjiri, ushqimi i koncentruar për majmëri
- ♦ Mbrojtja e deles mëmë – Kërkesat për lëndë ushqyese për prodhimin e qumështit për tre deri në pesë ditë janë afërsisht të njëjta si për prodhimin e një qengji 4 kg.
- ♦ Parandalimi i çrregullimeve të zhvillimit të delet që maturohen më herët
- ♦ Zhvillimi i ekuilibruar i qengjave nga lindjet e shumëfishta
- ♦ Ulja e rrezikut
- ♦ Majmëria nga mosha është dhjamosje
- ♦ Furnizimi i pamjaftueshëm i lëndëve ushqyese para pjekurisë seksuale nuk mund të përmirësohet më (nga pjekuria seksuale – rritja e akumulimit të yndyrës)



Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk
Tel: +355 (0)68 402 6311
e-mail: agri@ap.com.al

2. SI DALLOHET CILËSIA E MISHIT TË QENGJIT

Përpunuar nga Kristian Maka

Ngjyra e mishit

Mishi duhet të jetë me ngjyrë të kuqe të lehtë në ngjyrë tulle. Në përgjithësi, ngjyra e mishit është më e lehtë tek kafshët e reja.

Struktura

Përcaktohet kryesisht nga trashësia e fibrave të muskujve. Qengjat e rinj kanë fibra më të imta.

Butësia e mishit

Butësia e mishit ndikohet nga niveli i ndërlidhjes në indin lidhor.

- sa më e vjetër të jetë një kafshë – aq më shumë ind lidhor – koha më e gjatë gatimi (skuqje, avull, zjerje)
- sa më e re të jetë një kafshë – aq më pak ind lidhor – kohë më e shkurtër gatimi (pjekje në skarë, tiganisje)

Shpërndarja e yndyrës

Tendinat, shtresat e holla të yndyrës që përshkojnë mishin e muskujve. Kjo ruajtje e lehtë e yndyrës do të thotë që mishi mbetet më aromatik dhe i butë.

Kapaciteti mbajtës i lëngut/uji

Qengji pa yndyrë zakonisht përmban 75% ujë, kjo lidhet edhe me ngjyrën e hapur në të bardhë të mishit dhe me fibrat e vogla të mishit. Sa më fort të lidhet lëngu, aq më e lartë është cilësia.

Skema e EU për tregtinë e deleve dhe karkasave të tyre

Klasifikimi i karkasave të deleve kryhet duke vlerësuar në mënyrë sekuenciale karakteristikat e mëposhtme:

- Mishi
(6 Klasa: S, E, U, R, O, P);
- Indi dhjamor
(5 Klasa: 1, 2, 3, 4, 5).

Për klasifikimin në kategorinë S (klasi i parë), formimi i mishit nuk duhet të ketë asnjë mangësi.

S



E



U



Klas i parë

- Të gjitha profilet jashtëzakonisht konvekse
- Plotësi e jashtëzakonshme e muskujve me strukturë 2-fishe
- Të pasmet: Me muskuj të dyfishtë, shumë të rrumbullakosura, jashtëzakonisht të gjera dhe të trasha
- Kurrizi: shumë fort i rrumbullakosur, jashtëzakonisht i gjerë dhe i trashë
- Shpatulla: jashtëzakonisht e gjerë dhe e trashë

Shkëlqyer

- Të gjitha profilet konvekse deri në jashtëzakonisht konvekse
- Muskulaturë e jashtëzakonshme
- Të pasmet: shumë të trasha dhe të rrumbullakosura
- Kurrizi: shumë i rrumbullakosur, shumë i gjerë dhe i trashë në shpatull
- Shpatulla: shumë e rrumbullakosur dhe e trashë

Shumë mirë

- Profilet e përgjithshme konveks;
- Muskulaturë shumë e mirë
- Të pasmet: Të trasha dhe të rrumbullakosura
- Kurrizi: i gjerë dhe i trashë në shpatull
- Shpatulla: e trashë dhe e rrumbullakosur

R**Mirë**

- Profilet në përgjithësi të drejta
- Muskulaturë e mirë
- Të pasmet: kryesisht të sheshta
- Kurrizi: i trashë, më pak i gjerë në shpatull
- Shpatulla: e zhvilluar mirë, më pak e trashë

O**E mesme**

- Profilet të drejta deri në konkave
- Muskulaturë mesatare
- Të pasmet: pak të pjerrëta
- Kurrizi: më pak i gjerë dhe i trashë
- Shpatulla: pothuajse e ngushtë, pa trashësi

P**E ulët**

- Profilet nga konkave deri në shumë konkave
- Masë e ulët muskulore
- Të pasmet: të zhytura deri në shumë të fundosur
- Kurrizi: i ngushtë dhe i zhytur, me kocka të spikatura
- Shpatulla: e ngushtë, e sheshtë, me kocka të spikatura

1**Shumë e ulët**

- Mbulim shumë i vogël i yndyrës ose aspak
- Jashtë: Nuk ka yndyrë të dukshme ose vetëm shenja
- Brenda:
Zgavra e barkut– Nuk ka yndyrë të dukshme ose vetëm shenja
Zgavra e krahavorit– Nuk ka yndyrë të dukshme ose vetëm shenja

2**E ulët**

- Mbulesa e lehtë yndyrore; Muskulatura e dukshme pothuajse kudo
- Jashtë: Karkasa është pjesërisht e mbuluar me një shtresë të hollë yndyre, e cila mund të jetë më pak e theksuar në gjymtyrë.
- Brenda:

Zgavra e barkut: Veshkat janë pjesërisht të rrethuara nga gjurmë yndyre ose një shtresë e hollë yndyre.

Zgavra e krahavorit: Muskulatura midis brinjëve është qartë e dukshme.

3**E mesme**

- Muskulatura e mbuluar me yndyrë pothuajse kudo, përveç të pasmeve dhe shpatullave; depozitime të lehta yndyre në zgavrën e krahavorit
- Jashtë: Karkasa është plotësisht ose pothuajse plotësisht e mbuluar me një shtresë të hollë yndyre. Depozita të lehta yndyre në bazën e bishtit
- Brenda:

Zgavra e barkut: Veshkat janë të rrethuara plotësisht ose pjesërisht nga një shtresë e hollë yndyre.

Zgavra e krahavorit: Muskulatura midis brinjëve është ende e dukshme.

4



E fortë

- Muskulatura e mbuluar me yndyrë, por ende pjesërisht e dukshme në të pasmet dhe shpatullat; disa depozita të veçanta dhjami në zgavrën e kraharorit
- Jashtë: Karkasa është plotësisht ose pothuajse plotësisht e mbuluar me një shtresë të trashë yndyre, e cila mund të jetë pak më e hollë në gjymtyrë dhe pak më e trashë në shpatull.
- Brenda:

Zgavra e barkut: Veshka është e rrethuar nga një shtresë yndyre.

Zgavra e kraharorit: Muskujt midis brinjëve mund të ndërthuren me yndyrë. Depozitat e yndyrës mund të jenë të dukshme në brinjë.

5



Shumë i fortë

- Karkasë e mbuluar trashë me yndyrë; depozitime të rënda të yndyrës në zgavrën e kraharorit
- Jashtë: Mbulim shumë i rëndë yndyre, akumulime pjesërisht të dukshme të yndyrës
- Brenda:

Zgavra e barkut: Veshka është e rrethuar nga një shtresë e trashë yndyre.

Zgavra e kraharorit: Muskujt midis brinjëve janë të ndërthurura me yndyrë. Depozitat e yndyrës janë të dukshme në brinjë.

Faktorët që ndikojnë në cilësinë e qengjave

- Të ushqyerit
- Raca dhe predispozita gjenetike
- Mosha dhe pesha e therjes
- Rritja
- Masat e kujdesit dhe higjienës
- Procesi i therjes

Të ushqyerit e qengjave për prodhim cilësor të qengjit

Çfarë është qengji cilësor?

Nga këndvështrimi i fermerit, një qengj duhet të japë:

- fitime të larta ditore
- konvertim të mirë të ushqimit
- rendiment të lartë të therjes

Nga këndvështrimi i konsumatorit

- i vogël
- qengj me mish të plotë
- me pak dhjamë
- mishi të ketë ngjyrë të hapur
- "shija tipike e deleve" të jetë sa më pak e theksuar

Tomografia e kompjuterizuar

Përcaktimi i qëllimeve:

- Përparim më i shpejtë dhe më i mirë i rritjes së kafshëve përmes të dhënave bazë më të shumta dhe më të mira duke shfrytëzuar teknologjinë të sakta suke shfrytëzuar teknologjinë e fundit
- Marketing më i mirë për konsumatorin me anë të mbarështimit
- Përmirësimi i cilësisë – përfitim më i lartë
- Përzgjedhje më efikase e kafshëve mbarështuese
- Nuk është e nevojshme therja e kafshëve

PROCESI AKTUAL I MATJES

Regjistrimet:	Vlerat e matura të përcaktuara:
1) Pasqyra e parë: zona e brinjëve, rruazave/shpatullave	Gjerësia e shpatullave, gjatësia e brinjëve të kurritit
2) Pamje e detajuar: midis vertebrës së 5-të dhe të 6-të	zona e yndyrës, mishit, kockave; thellësia e gjoksit (skeleti i jashtëm); Vlera HU në strukturën e muskujve bazë (x,y)
3) Pamje e detajuar: midis rruazave të 10-të dhe 11-të	zona e yndyrës, mishit, kockave; Vlera HU në strukturën e muskujve bazë (x,y)
4) Pasqyra e dytë: zona e rruazave lumbare duke përfshirë ijet	gjatësia e shtyllës kurrizore; gjerësia e legenit
5) Pamje e detajuar: midis rruazave të 3-të dhe të 4-të të mesit	zona e yndyrës, mishit, kockave; Vlera HU në strukturën e muskujve bazë (x,y)
6) Foto me detaje: në fundin e pasmë të acetabulumit	Madhësia e kanalit të lindjes (sipërfaqja)

Për më shumë informacion:



QF Qendra e Formimit
PB Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355(0)68 402 6311
e-mail: agri@ap.com.al

3.MË SHUMË PROFESIONALIZËM NË MBARËSHTIMIN E TË IMTAVE

Përpunuar nga Kristian Maka.

Mbarështuesit e deleve në Austrinë Veriore kanë arritur një status të veçantë të blerësit, nëpërmjet cilësisë së lartë të mishit të deles.

Para një dekade, një grup mbarështuesish delesh filloi me prodhimin e mishit cilësor të qengjit. Paraprakisht u krye përcaktimi i termit "cilësi".

Tiparet dalluese të mishit cilësor:

- **Ngjyra e mishit:** mishi i qengjit duhet të ketë një ngjyrë të kuqe të hapur deri në të kuqe tulle. Zakonisht tek kafshët e reja, ngjyra e mishit është më e hapur.

- **Struktura:** përcaktohet nga trashësia e fibrave muskulore. Mishi i qengjit të njomë ka fibra më fine.

- **Butësia:** butësia e mishit ndikohet nga përmbajtja e rrjetëzimit të indeve lidhëse. Sa më e vjetër (në moshë) të jetë kafsha, aq më shumë inde lidhëse ka, si dhe aq më e gjatë koha e zierjes (pjekjes, skuqjes etj). Sa më e re të jetë kafsha, aq më pak inde lidhëse ka, si dhe aq më e shkurter koha e zierjes (pjekjes, skuqjes etj).

- **Shpërndarja e yndyrës:** me "mermerizim" kuptohen pjesët e holla të dhjamosura, të cilat përshkojnë indin muskular. Këto depozitime të lehta yndyre e bëjnë mishin më aromatik dhe të butë.

- **Aftësia e lidhjes së ujit:** mishi "pak i dhjamosur" përmban si rregull 75% ujë, i cili në mënyrë të natyrshme është i lidhur në proteinat e mishit dmth në fibra shumë të imta. Sa më fort të jetë lidhur uji në këto fibra aq më e lartë vlerësohet cilësia.

Për këtë, u bashkëpunua me studentë të Universitetit Ekonomik në Linz. Fermerët kishin detyrën të prodhonin pikërisht atë mish qengji, të cilin dëshironin konsumatorët. Ekspertët e shoqatës dhe mbarështuesit e deleve përpunuan linjat dhe kriteret, të cilat mbështesnin arritjen e këtij qëllimi në praktikë. Personat përgjegjës u bindën shumë shpejt që prodhimi i cilësisë së lartë të mishit, mundësohet vetëm me kafshë race, të cilat duhet të mbahen dhe ushqehen shumë mirë.



Në stadin fillestar të punës sonë ne referuam tek mbarështuesit e të imtave mbi punën mbarështuese, metodat e reja të ushqimit dhe rritjes, por hasëm në vështirësi. Veçanërisht skepticizëm ndeshëm në përdorimin intensiv të koncentratit dhe periudhën e shkurtër të majmërisë.

Një dhjetëvjeçar më vonë konstatuam gjithmonë e më shumë mbarështues delesh dhe dhish, të cilët pranonin mënyrën tonë të këshillimit, "know-how" (të dish-si) dhe njohuritë tona profesionale dhe mbarështonin e prodhonin në përputhje me to.

Suksesi na jep të drejtë

Në të gjithë Europën nuk prodhohet dhe shitet në asnjë vend, cilësi e tillë e lartë mishi qengji si në Landin e Austrisë së Sipërme. Rezultati është një situatë stabiliteti e tregut me nivel të lartë çmimi, i shoqëruar me kërkesa gjithmonë e në rritje për produktet tona.

Suksesi i arritur bind gjithnjë e më tepër sipërmarrës të rinj dhe ata të cilët kërkojnë të ndryshojnë strukturën e fermës së tyre. Në kërkimet tona, ne mbajmë parasysh rritjen e cilësisë së jetës dhe kohën e lirë të fermerëve tanë. Shpenzimet e investimit duhet të mbahen sa më ulët të jetë e mundur.

Teknologjia e lartë në mbarështimin e të imtave, i krijon mundësinë dhomës së bujqësisë të Landit të Austrisë së Sipërme të ofrojë prej vitesh një gamë të gjerë seminaresh shumë të vlefshëm për mbarështuesit e tyre.

Është vërtetuar që fermerë të specializuar dhe profesionalë janë në gjendje ta përballojnë shumë më lehtë të ardhmen dhe sfidat e tregut, në krahasim me fermerët që bëjnë investime të panevojshme me para e fuqi punëtore.

Përlllogaritjet në studime të ndryshme kanë treguar se mbarështimi i deleve dhe i dhive është rentabël vetëm në atë rast, kur punohet me profesionalizëm.

Mundësitë për arritjen e saj krijohen nëpërmjet dhomave vendore të bujqësisë.

Faktorët që ndikojnë në rentabilitet:

- Raca për rendimente të larta (p.sh. Merino)
- Predispozitat më të mira gjenetike (kushtet: testimi CT dhe ekzaminime shëndetsore)
- Mirëmbajtja dhe sistemimi i stallës në përputhje me nevojat e kafshës (stalla të ndriçuara dhe të ajrosura)
- Përdorimi i ushqimit voluminoz dhe koncentratit të cilësisë së lartë
- Koha e përshtatshme e therjes (therje duke eliminuar streset)
- Përpunim profesional i karkasës (në copëzim apo ndarje)
- Marketing dhe logjistikë e përshtatshme

Në të gjitha bisedat këshilluese, aktivitetet e ndryshme dhe nëpër seminare, fermerët informohen në mënyrë të vazhdueshme për rentabilitetin e mbarështimit të deleve.

Delja e qumështit përbën gjithashtu një veçori shumë specifike. Për të qënë i suksesshëm me këtë racë, në rradhë të parë nevojitet vullneti, shkathtësia, si dhe aftësia në shitje. Ekzistojnë raca të tëra delesh, të cilat nuk janë të përshtatshme për të qënë rentable. Për këtë arsye çdo person, i cili në të ardhmen dëshiron të rritë dele duhet të ketë parasysh rentabilitetin dhe të ardhurat në fermën e tij.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk Tel:

+355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

4. PRODUKTET E QUMËSHTIT TË DELES - NË TRENDIN E KOHËS

Përpunuar nga Kristian Maka.

Qumështi i deleve gjen përdorim edhe sot, ndonjëherë edhe si ushqim për fëmijë. Anëtarët e fiseve Kaukaziane e konsiderojnë qumështin e deleve një eliksir për shëndetin dhe jetëgjatësinë. Shumë popuj e përdorin qumështin e deleve si ushqim tradicional, si produkt kozmetik apo si ilaç natyral kundër disa sëmundjeve duke e konsideruar një furnizues energjie që forcon sistemin imunitar. Në sytë e njerëzve nga vendet perëndimore, qumështi i deleve dhe nënproduktet e tij, veçanërisht kosi i deleve konsiderohet si një ushqim për jetëgjatësi.

Përveç vlerave për shëndetin, një fokus të veçantë ka edhe shija Gourmet. Komponenti i shijes i produkteve të qumështit të deleve si dhe modalitetet individuale të përpunimit të djathit, kosit ose qumështit si një aditiv në gatime të ndryshme e rrisin në mënyrë mjaft të ndjeshme rëndësinë e qumështit të deleve dhe produkteve të tij. Sot, shumica e klientëve në restorante presin me padurim ushqime të tilla.

Përbërësit e qumështit të deleve

për 100 gr. sub të kons.	Ujë	Proteine	Yndyrna	Karbohidrate	Kalcium	Fosfor	Energji
Qumështi i deleve	pH 6,54	5,6 g	7,5 g	4,4 g	190 mg	150 mg	448 kJ

E veçanta e qumështit të deleve është përmbajtja e lartë e acidit orotik (450 mg/l), 3 - 4 herë më shumë se sa te qumështi i lopës. Acidi orotik është një fazë e ndërmjetme në sintezën e pirimidinës, e cila nga ana tjetër kërkohet për të ndërtuar acidin nukleik. Acidi orotik ka një efekt të fortë rigjenerues në qelizë, veçanërisht në mëlçi dhe në traktin gastrointestinal. Përveç kësaj, ai vepron si një substancë transportuese për magnezin, i cili nga ana tjetër është një mineral i rëndësishëm me efekte antikancerogjene.

Një tjetër substancë antikancerogjene që gjendet në sasi të mëdha në qumështin e deleve është amigdalina, që i jep atij edhe aromën e lehtë të bajames. Delet e marrin atë përmes ushqimit të tyre. Amigdalina gjendet në barërat e livadheve dhe farat e tyre, të cilat përbëjnë deri në 40% të sasisë së ushqimit. Është e provuar që delet janë rezistente ndaj kancerit.

Qumështi i deleve përmban një sasi më të lartë vitaminash në krahasim me qumështin e lopës. Vlerat e qumështit të deleve janë përgjithësisht shumë herë më të larta se ato të qumështit të lopës.

Shumë njerëz nuk e dinë se shumë sëmundje vijnë si

pasojë e ushqimit të gabuar ose të njëanshëm. Nëse raporti acid/bazë nuk është i saktë, trupi duhet të nxjerrë acidin dhe proteinat e tepërta nëpërmjet organeve, si mukoza e zorrëve, rrugët e frymëmarrjes, hundët dhe kyçet. Si pasojë mund të shkaktohen sëmundjet kronike ose alergji. Shumë njerëz janë alergjikë në veçanti ndaj qumështit të lopës, i cili zakonisht fillon në foshnjëri; kur kalohet nga qumështi i gjirit në qumështin zëvendësues.

Qumështi i deleve dhe i dhisë përmban përbërës që janë lehtësisht të tretshëm.

Qumështi i deleve është padiskutim qumështi më i mirë, nëse i referoheni vlerave të tij ushqyese apo vlerave mjekësore. Përafërsisht dyfishi i përqindjes së lëndës së thatë në qumështin e deleve, krahasuar me qumështin e lopës ose të dhisë, dyfishon rendimentin e djathit.

Ashtu si me çdo qumësht tjetër mund të gatuani edhe me qumështin e deleve, por gjithmonë duhet ta holloni pak, për shkak të përqindjes më të lartë të lëndës së thatë. Sigurisht, mund ta konsumoni të paholluar apo për t'ia hedhur kafes, me muesli ose si një pije kremoze duke e përzier me manaferra të freskëta. Ajka e qumështit mund të përdoret si krem pana. Kur acidifikohet, ka shijen e Crème fraîche. Gjalpi nga qumështi i deleve konsiderohet një specialitet. Produktet e qumështit të thatë janë lehtësisht të tretshme dhe kanë një jetëgjatësi relativisht të gjatë. Kosi me qumësht deleje shkon gjithashtu me manaferra.

Kefiri, kjo pije probiotike u ka sjellë dobi njerëzve fizikisht dhe mendërisht për mijëra vjet. Me një game të gjerë produktesh të ndryshme të djathit (gjizë dele, krem djathi, djathë i butë, kamember, djathë gjysmë i fortë) mund të përgatiten për raste festash pjata shumë të bukura dhe të shijshme.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

5.TË USHQYERIT E DELEVE DHE MBARËSHTIMI I QENGJAVE

Përpunuar nga Kristian Maka

Qëllimi i mbarështimit të deleve dhe dhive është që t'i shërbejë tregut me produkte cilësore të mishit dhe të qumështit. Për t'a arritur këtë, elementë thelbësorë janë strategjitë e suksesshme të menaxhimit dhe furnizimit me ushqim.

Numri i qengjave të lindur mund të rritet me anë të të ushqyerit „Flushing“. Nëpërmjet të ushqyerit deri në 0,4 kg ushqim të koncentruar për krerë dele në ditë, rritet kuota e ovulimit dhe bashkë me të edhe shifra e lindjeve të binjakëve. Të ushqyerit e deleve barse ose deleve të qumështit ndikon në rritjen e peshës së lindjes së qengjave. Nëse qengjat lindin rreth 5 kg, mund të zvogëlohen humbjet e hershme.

Majmëria profesionale e qengjave

Majmëria e qengjave fillon me 15-20 kg dhe përfundon me 45 kg. Zbulimet më të reja tregojnë se në ushqimin e qengjave me rëndësi nuk është vetëm përmbajtja, por gjithashtu edhe raporti energji-proteinë. Një raport pothuajse i njëjtë çon në majmëri të parakohshme, ndërsa një raport me proteinë të lartë rrit rrezikun ndaj diarresë. Marrja mesatare ditore prej 300 g garanton kostot më të ulëta të koncentratit për kg peshë të gjallë. Përmbajtja e mineraleve dhe vitaminave në racionin ushqimor të qengjave ka një ndikim të madh në vitalitetin dhe shëndetin e tyre. Nëse ka më shumë probleme, (sëmundja e muskullit të bardhë) kjo tregon mungesë të selenit dhe vitaminës E. Në të kundërt, ushqimet minerale që përmbajnë bakër mund të çojnë në simptoma të helmimit të delet. Gurët urinarë, veçanërisht të qengjat e rinj meshkuj, janë shpesh rezultat i një raporti tepër të ngushtë Ca:P (Kalçium:Fosfor) të kombinuar me mungesën e kripës dhe ujit. Për të ruajtur aktivitetin e rumenit, ka rezultuar efektiv shtimi i 1/4 kg kashtë në majmërinë e qengjit.

Kritere të rëndësishme cilësie në ushqimin për majmëri të qengjave:

- Raporti-Energji-Proteinë: 18:1
- Energjia
- Proteina
- Raporti Ca:P
- Përmbajtje e lartë e vitaminës E dhe e selenit
- Tretja sa më e mirë e lëndëve ushqyese

Për prodhimin e mishit të qengjit kërkohet marrja e një doze të lartë ditore të këtyre lëndëve, karkasa duhet të jetë me sasi të konsiderueshme mishi dhe shtresë të lehtë dhjami. Për këtë është e rëndësishme përbërja e ushqimit për majmërinë e qengjit. Për kuota më të mira rritjeje, me konsum më të ulët të koncentratit është i nevojshëm një raport 18:1 energji- proteinë. Koncentrati për majmërinë e qingjave LämmerKorn Top promovon rritje të ndjeshme të masës së muskulare dhe siguron një zhvillim të njëtrajtshëm të qengjave me anë të suplementeve të vitaminave dhe mineraleve.

Problemi	Periudha të zgjatura të majmërisë me kuota të larta dështimi
Simptoma:	Zhvillimi i pabarabartë i qengjave
Zgjidhja:	LämmerKorn Top - koncentrat me përmbajtje proteine dhe energjie të balancuar si edhe pasurimi me minerale dhe vitamina
Përdorimi:	Pas ndërprerjes së gjirit (15-20 kg) deri në fund të periudhës së majmërisë (45 kg)
Sasia e përdorimit:	LämmerKorn Top përzihet me 1/4 kg kashtë

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

6. TË USHQYERIT E TË IMTAVE

Përpunuar nga Dardan Grajçevci

Ushqimi i kafshëve përmban lëndë ushqyese të papërpunuara, të nevojshme për kafshën, të cilat shpërbëhen në mënyrën e duhur nëpërmjet tretjes. Këto janë lëndë ushqyese organike si proteina, yndyra, ekstrakte pa azot/nitrogjen (kryesisht niseshte dhe sheqer), fibra të papërpunuara (kryesisht muret e qelizave bimore dhe celuloza) dhe lëndë ushqyese organike ose minerale (elementë të shumtë dhe elementë gjurmë/mikroelement).

Përbërës të tjerë aktivë të rëndësishëm janë vitaminat, të cilat në sasi të vogla mund të ndikojnë në zhvillimin e metabolizmit ose aftësisë tretëse të kafshës. Substancat e huaja metabolike janë gjithashtu prezente. Veçanërisht të njohur janë antibiotikët e prodhuar nga kërpudhat, të cilët pengojnë rritjen dhe funksionin jetësor të baktereve. Përveç lëndëve ushqyese të përmendura, këtu shtohet edhe një sasi e konsiderueshme uji. Kafsha mund të plotësojë nevojat e saj për proteina vetëm nëpërmjet ushqimit që përmban proteina (pra me përmbajtje të albuminave). Yndyra shtazore, nga ana tjetër, mund të plotësohet jo vetëm nga yndyrnat bimore, por edhe nga karbohidratet dhe proteinat. Lëndët ushqyese komponente të ushqimit fitohen nëpërmjet tretjes.

Standardet e kërkesave për lëndë ushqyese përdoren për të llogaritur racionet e ushqimit. Në praktikë, këto standarde nuk mund të përmbushen gjithmonë në mënyrë ekzakte. Për lëndët ushqyese të klasave të veçanta të moshës dhe gjinisë, janë krijuar tabela të lëndëve ushqyese mbi bazën e studimeve të detajuara, të cilat bëjnë të mundur krijimin e një përbërjeje ushqimore që korrespondon me nevojat përkatëse ushqyese të kafshës.

Të ushqyerit e deshve të mbarështimit

Për periudhën e mbarështimit, duhet të jepet një sasi shtesë për të kompensuar rritjen e konsumit të proteinave dhe rritjen e aftësisë së fekondimit. Në praktikë, është dëshmuar efektive rritja e përqindjes së tërshërës në racionin e ushqimit me 1 kg në ditë.

Të ushqyerit e deleve

"Flushing", ushyerja përpara periudhës së mbarështimit të deleve, me qëllim që në këtë mënyrë të arrihet një shkallë më e lartë e ovulimit (koha para ndërzimit) dhe kjo kontribuon në një numër më të madh të lindjeve të qengjave. Nëpërmjet kësaj ushyerjeje, delja duhet të sillet në një gjendje ushqimi në rritje, vetëm kjo shkakton efektin e dëshiruar. "Flushing" fillon tre deri në katër javë para sezonit të mbarështimit. Përveç ushqimit voluminoz cilësor, jepet edhe koncentrat i pasur në proteina.

Të ushqyerit me minerale

Gjatë gjithë vitit duhet të vendosen në dispozicion për të gjitha delet gurë për të lëpirë, në mënyrë që të mbulohen nevojat e tyre për kripë. Përzierjet e koncentrateve të blera kanë si rregull tashmë një përzierje mineralesh në masën prej 3%.

Qëllimi dhe synimi i të ushqyerit duhet të jetë përdorimi i sa më shumë ushqimeve voluminoze të cilësisë së mirë, të prodhuar në fermë. Duhet të merren parasysh kërkesat e veçanta të deleve për ushqime të ndryshme.

Kullota

Lartësia e barit duhet të jetë 10 deri në 15 cm. Nëse bari i kullotës është më i lartë, humbjet janë të mëdha, sepse delet e shkelin ushqimin dhe më pas nuk e hanë. Sa më e lartë të jetë rritja e barit për kullota, aq më e vogël duhet të jetë sipërfaqja që ricaktohet për delet.

Foragjeret jeshile në stallë

Nëse në hambar jepen foragjere të gjelbra, duhet pasur kujdes i veçantë për t'u siguruar që të mos përfshihen bimë helmuese (zhabinë/ ranunculus, qumështorja/ euphorbia, etj.), pasi delet nuk mund t'i përzgjedhin aq mirë këto bimë në lug aq sa munden në kullotë.

Sana (bari i thatë)

Deleve nuk u pëlqen të hanë sanë me kërcell të gjatë, me përmbajtje të lartë fibrash të papërpunuara, kështu që foragjeret duhet të korren herët.

Silazhi

Ushqyerja duhet të realizohet vetëm me silazh të pastër, në rast fermentimi të gabuar ekziston rreziku i listeriozës; te kullat e sheshta dhe të larta të silloseve duhet patur kujdes sasia minimale ditore e tërheqjes, për rezervat më të vogla janë shpesh dengjet e silazhit më të përshtatshme.

Kashta

Kashta mund t'u jepet deleve kur ka mungesë të ushqimit voluminoz dhe në të njëjtën kohë jepet koncentrat; kashta përdoret gjithashtu në majmërinë e qengjit si kompensues i fibrave të papërpunuara. Është e rëndësishme që kashta e përdorur të jetë absolutisht pa myk.

Në praktikën e të ushqyerit dallojmë disa seksione

- Përgatitja për pozicionimin më të mirë (i ashtuquajtur i ushqim me shpëlarje „Flushing“)
- Silazh i mirë, 200 deri në 300g koncentrat).
- Dele me barrë të lehtë (deri në fund të muajit të 3-të të shtatzënisë).

Foragjere kullote, silazh, sanë, kashtë (ushqimi i koncentruar nuk është i nevojshëm). Ushqimi mineral duhet të jetë gjithmonë i disponueshëm.

Receta ushqimore:

Vera:

25 % Kashtë, bar i thatë
25 % Tërshërë
25 % Elb
22 % Misër/Grurë
3 % Ushqim mineral për delet

Dimri:

25 % Kashtë, bar i thatë
25 % Tërshërë
25 % Elb
22 % Bathë/bizele
3 % Ushqim mineral
ose
25 % Kashtë, bar i thatë
25 % Tërshërë
32 % Elb
15 % Miell soje
3 % Ushqim mineral

Nga këto përzierje, 0,3 deri në 0,5 kg për dele në ditë u jepet deleve me barrë të rëndë dhe në gji. Në princip, delet me një qengj dhe me binjakë duhet të mbahen veçmas në mënyrë që të mund të sigurojnë ushqim për kafshët sipas nevojave të tyre.

Cilësia e mirë e ushqimit voluminoz (ushqim pa myk, i pastër) është kusht për mbarështimin e deleve.

Recetë:

1,0 kg Sanë
1,0 kg Silazh bari
1,5 kg Silazh misri+ Kashtë për ushqim ose
3,0 kg Silazh bari
1,0 kg Sanë+ Kashtë për ushqim

Në këtë fazë delja nuk duhet të shëndoshet shumë, në mënyrë që të mos ndodhin lindje të nderlikuara.

- Dele me barrë të rëndë dhe me gji

Delet me barrë të rëndë dhe gjidhënëse kanë nevojë për një ushqim të përgatitur në mënyrë të përshtatshme për të plotësuar ushqimin me bazë foragjere të rritur në fermë. Në të ushqyerit e verës (kullotë e mirë, pak sanë), koncentrat nuk duhet të përmbajë një përbërës proteinik; vetëm në dimër është i nevojshëm plotësimi i proteinave nëpërmjet koncentratit, veçanërisht me ushqimin voluminoz të pasur me energji.

Të ushqyerit e deleve qumështore

Delet qumështore në gji duhet të ushqehen në mënyrë specifike sipas rendimentit të qumështit, d.m.th. ushqimi me koncentrat bazohet në nivelin e rendimentit të qumështit dhe në cilësinë e ushqimit voluminoz. Në përgjithësi, mund të thuhet: Sa më e mirë të jetë cilësia e ushqimit voluminoz, aq më shumë koncentrat mund të kursehet. Në kushte të mira kullotjeje, delet qumështore konsumojnë deri në 11 kg bar në ditë. Kjo sasi mbulon kërkesat për një rendiment të mirë të qumështit prej 1 kg. Rendimentet më të larta të qumështit kërkojnë ushqim të synuar me koncentrat prej 0,6 kg për çdo kg qumësht. Kështu, për një rendiment qumështi prej 3 kg, nevojiten 1,2 deri në 1,5 kg koncentrat, në varësi të cilësisë së ushqimit bazë. Gjatë përgatitjes së ushqimit rendiment, duhet të merret parasysh përmbajtja e energjisë dhe proteinave të ushqimit voluminoz.

Të ushqyerit për qengja të shëndetshëm

Zhvillimi fillestar tek qengjat varet nga dhënia e kulloshtrës. Kulloshtira gjithashtu mund të ngrihet dhe t'u jepet qengjave sipas nevojës. Gjatë fazës së parë të jetës, qengjat mbështeten në qumështin e nënës së tyre ose në zëvendësuesit e qumështit me yndyrë të plotë. Nga java e dytë e jetës mund të shtohen ushqimi i koncentruar dhe sana. Në moshën rreth gjashtë deri në shtatë javë, pjesa e përparme e stomakut është zhvilluar deri në pikën ku

kërkesat për lëndë ushqyese mund të plotësohen përmes ushqimeve me bazë bimore. Objektivi për qengja të shëndetshëm është të prodhohet një karkasë e qengjit e cilësisë së dëshiruar nga konsumatori, duke marrë parasysh efikasitetin ekonomik. Kjo korrespondon me një peshë të gjallë prej rreth 40 deri në 45 kg dhe një peshë karkase prej 18 deri në 25 kg me muskulaturë të mirë.

Idealja është prodhimi intensiv i qengjave

Për periudhën e majmërisë, qengjat shkëputen nga nënat e tyre në moshën gjashtë deri në tetë javë (afërsisht 20 kg peshë të gjallë) dhe strehohen në fermë. Qengjat ushqehen me një dietë të pasur me 20% proteina të papërpunuara për konsum të lirë. Kashta ofrohet gjithashtu, për të siguruar një furnizim adekuat të fibrave të papërpunuara. Me këtë metodë të ushqyerit, qengjat janë gati për therje në muajin e tretë deri në të katërtin.

Konsumi mesatar i ushqimit për qengj në ditë: 20

kg Peshë e gjallë	0,6 kg
25 kg Peshë e gjallë	0,9 kg
35 kg Peshë e gjallë	1,0 kg
40 kg Peshë e gjallë	1,2 kg

Përzierjet minerale të përdorura duhet të kenë një raport Ca:P prej 2:1 deri në 3:1. Përzierjet minerale të destinuara për gjedhin dhe derrat nuk janë të përshtatshme për qengjat dhe delet për shkak të niveleve të larta të bakrit.

Kequshqyerja është humbje e ushqimit

- Shpesh abuzohet me dhënien e ushqimit optimal
- Kequshqyerja është humbje e ushqimit dhe reduktim i cilësisë së karkasave.
- Në periudhën para pjekurisë seksuale (deri në 100 ditë të jetës), ndodh rritja kryesore e indit muskolor, kështu që është i nevojshëm furnizimi i bollshëm me lëndë ushqyese.

Përparësitë e heqjes së hershme të gjirit në prodhimtarinë e qingjave

- Shmangia e humbjeve të rafinimit për shkak të prodhimit të qumështit të nënës.
- Zvogëlohet rreziku e lëndimit të gjirit (mastitit infektiv).
- Rritja e prodhimit të mishit në majmëri me bazë kullotën.
- Mbrojtja e deles mëmë.
- Parandalimi i çrregullimeve të zhvillimit të delet.
- Shkurtimi i periudhës midis lindjeve (nxitja e afshit me anë të stazës së qumështit gjatë shkëputjes nga gjiri).

Zhvillimi më i ekuilibruar i qengjave nga lindjet e shumëfishta.

- Reduktimi i rrezikut të infektimit nga parazitët në stallave (më pak mjekim).
- Ulja e dhjamosjes së qengjave pasi theren më të rinj (rritja e yndyrës nga pjekuria seksuale).
- Një parakusht për shkëputjen e hershme të suksesshme nga gjiri është të paktën 20 kg, si dhe marrja e mjaftueshme e koncentratit tashmë gjatë periudhës së gjirit.

MBARËSHTIMI

Kullota

Ka disa opsione për mbajtjen e deleve në kullotë:

- Gardhi fiks: Ndarja e zonës së kullotës në disa livadhe me anë të rrjetave të zinkuara me nyje. Duhet të krijohen aq hapësira sa delet të mos kullosin në një vend për më shumë se pesë deri në gjashtë ditë për arsyet e mëposhtme:

1. Reduktimi i rrezikut të krimbave duke ndërprerë ciklin e zhvillimit të parazitëve të ndryshëm të brendshëm.
2. Ruajtja e performancës së tokave me kullotë për një pauze mjaft të gjatë.
3. Lartësia ideale e rritjes dhe për rrjedhojë përbërje ideale e lëndëve ushqyese.

- Gardhi elektrik: Sistemi më i përdorur është rrethimi me rrjeta (të ashtuquajturat Flexinet). Këto rrjeta 50 m të gjata mund të vendosen dhe të hiqen shpejt nga një person, duke e bërë këtë sistem të përshtatshëm për kullotjen e tufave.

Një sistem i dytë i gardhit elektrik me dy deri në tre tela nën tension. Zona të mëdha mund të rrethohen menjëherë me një kosto të ulët, por ky gardh nuk është aq i sigurt në rastin e kalimit të qengjave të rinj. Një avantazh i madh i të gjitha sistemeve të gardheve elektrike është lehtësia në montim dhe zhendosja e thjeshtë. Ekzistojnë gjithashtu forma të përziera të sistemeve të ndryshme të rrethimit, të tilla si një gardh fiks në natyrë dhe ndarja e zonës me ndihmën e një gardhi elektrik.

Furnizimi me stok i kullotave

Stoku i kullotjes është numri i deleve me pasardhës për ha sipërfaqe foragjere në vit, me foragjere dimërore (sanë, silazh) të marra gjithashtu nga kjo sipërfaqe. Shkalla e grumbullimit varet nga cilësia dhe rendimenti i zonës së kullotjes. Si rregull, për ha mund të mbahen pesë deri në dhjetë dele me qengja.

7. MBARESHTIMI DHE TE USHQYERITTE TE DHIRTAT

Përpunoi: Kristian Maka

Për një shëndet të mirë të dhive dhe performancë në plan afatgjatë duhet treguar kujdes në mënyrën e të ushqyerit. Në racionin e ushqimit duhet të përfshihen lëndë ushqyese të mjaftueshme dhe fibra të papërpunuara. Dhitë mund të përdorin më mirë fibrën e papërpunuar të vështirë për t'u tretur sesa ripërtypësit e tjerë me ndihmën e mikroorganizmave në rumen.

Dhitë konsiderohen modeste dhe performojnë dobët në ushqimet me vlera të ulëta ushqyese. Performanca e lartë kërkon një racion ushqimor të përqendruar të pasur me lëndë ushqyese.

Trakti tretës përbëhet nga goja, ezofagu, rumeni si stomaku kryesor, 3 stomakë dytësorë (retikulum, abomasum, omasum), zorra e hollë, zorra e trashë dhe rektumi. Tek qengjat, abomasumi është më i zhvilluari, ai është përgjegjës për tretjen e qumështit. Ushqimi i koncentruar, mbetjet e drithërave të dhëna në formë të lëngshme (si supë) gjithashtu hyjnë në abomasum, por nuk mund të treten atje. Prandaj, nuk rekomandohet ushqyerja me ushqime të lëngshme (përveç qumështit). Ushqimet e ngurta shpërbëhen në pjesën e përparme të stomakut. Tretja kryesore e ushqimit bëhet në zorrën e hollë. Përthithja e lëndëve ushqyese ndodh kryesisht përmes vileve të zorrëve.

Konsumi i ujit

Pirja e ujit është shumë e rëndësishme për tretjen e ushqimit dhe për të ruajtur funksionet e trupit. Një dhi e rritur ka nevojë për rreth 6-10 litra ujë në ditë. Furnizimi i pamjaftueshëm me ujë ndikon negativisht në marrjen e ushqimit.

Konsumi i ushqimit

Tretshmëria e ushqimit është shumë e ndryshme dhe varet nga përmbajtja e fibrave të papërpunuara. Dhitë me rendiment të lartë qumështi kërkojnë ushqim me një përqendrim më të lartë të lëndëve ushqyese. Një dhi e rritur ka nevojë për rreth 2 kg bar të cilësisë së mirë në ditë, si nevojë mirëmbajtjeje. Nëse dhitë duhet të kenë një performancë të lartë (qumësht, përfitime ditore), ushqimi bazë më i mirë ose/dhe ushqimi i koncentruar duhet të jepet si ushqim shtesë.

Të ushqyerit në prodhimin e qumështit

Dhitë janë në performancë të plotë 8-10 ditë pas lindjes. Prandaj, pas lindjes së kecit, cilësia dhe përqendrimi i lëndëve ushqyese në ushqim është veçanërisht e rëndësishme.

Pavarësisht ushqyerjes me ushqimin më të mirë, vërehet një humbje në peshë në kafshët me performancë të lartë. Dhitë e reja, të cilat lindin për herë të parë dhe ende nuk janë rritur plotësisht, gjithashtu kanë nevojë për ushqim me përqendrim të lartë të lëndëve ushqyese, në mënyrë që pesha përfundimtare e trupit të arrihet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të prodhojnë një rendiment të lartë qumështi në laktacionin e dytë.



Gjatë përgatitjes së racionit të ushqimit, është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje shijimit. Fermeri i dhive mund ta përpilojë vetë racionin e ushqimit.

Shembuj recete

Rendimenti i qumështit të një dhie që peshon 60 - 70 kg:
rreth 3 kg qumësht - 0,4 kg koncentrat
rreth 4 kg qumësht - 0,8 kg koncentrat
rreth 5 kg qumësht - 1,0 kg koncentrat
rreth 6 kg qumësht - 1,2 kg koncentrat

Ushqim voluminoz i pasur me proteina	Si kompensim koncentrat i me energji të lartë
Livadh, kullotë, sanë, silazh bari, të korrat e dyta	20 % Të korra të thata 10 % Bathë / Bizele 25 % Misër / Grurë 30 % Elb 12 % Tërshërë 3 % Ushqim mineral (pa bakër)

Ushqim voluminoz i pasur me proteina	Si kompensim koncentrat i me energji të lartë
Sanë, panxhar foragjer, kashtë, silazh misri	20 % Të korra të thata 40 % Bathë / Bizele 15 % Misër / Grurë 21 % Elb 3 % Ushqim mineral (pa bakër)

Në përzierjen minerale, përmbajtja e bakrit nuk duhet të kalojë 30 mg / kg TM në ushqim. Në shumicën e rasteve, mund të përdoret e njëjta përzierje minerale si për bagëtinë. Rekomandohet ofrimi i kripës për konsum.

Të ushqyerit në periudhën e tharjes

Pas tharjes, ushqimi mund të kufizohet në fillim (pak mbi kërkesat e mirëmbajtjes). Në fund të barrës (6 javë para lindjes) shtohen kërkesat për lëndë ushqyese. Në fazën e pikut të barrës, dhia ha më pak për sa i përket vëllimit, kështu që ushqimi duhet të ketë shumë vlera. Prandaj rekomandojmë ushqim të mirë voluminoz (sanë, silazh) dhe 30-60 dag koncentrat, në varësi të cilësisë së ushqimit voluminoz, ujë të freskët dhe kripë për konsum të lirë.

Sanë me cilësi të mirë, silazh dhe foragjere jeshile janë baza për rritjen e shëndetshme të kafshëve.

Mbarështimi i dhive

Formimi i spermatozoideve fillon te ftujakët në moshën rreth 5 muajsh. Fillimisht, qelizat e spermës janë të një cilësie të ulët. Cilësia e spermës përmirësohet me shpejtësi dhe arrin cilësinë e cjepëve në moshën rreth 6 muajsh. Ka dallime sezonale në aktivitetin seksual ndërmjet cjepëve. Megjithatë, kjo nuk është e njëjtë për të gjitha racat. Ashtu si me dhinë, stimuli te cjapi vjen nga ndryshimi i gjatësisë së ditës (ditë të shkurtra - netë të gjata -> cilësi shumë aktive dhe e mirë e spermës) + (ditë të gjata - netë të shkurtra -> cilësi më pak aktive dhe e dobët e spermës). Aroma seksuale e cjapit vjen nga sekrecionet e gjendrave të lëkurës, të cilat ndodhen kryesisht pas brirëve dhe në faqe. Aroma seksuale është shumë më e ulët jashtë sezonit dhe pothuajse mund të zhduket. Meshkujt mund të çiftëzohen 10 deri në 20 herë në ditë. Në një eksperiment u përcaktua se vetëm pas një mesatare prej 7 kërcimesh, pauzat në kërcimin tjetër u bënë më të gjata se 10 minuta. Steriliteti gjenetik i meshkujve shfaqet më shpesh tek ata pa brirë.

Meshkujt që vrapojnë të lirë në një kope me dhi përqëndrohen zakonisht te një dhi e vetme me afsh. Mund të jetë e lehtë për dhinë të tjerë në afsh të injorohen nga cjapi. Dhinë mund të refuzojnë cjepër të caktuar. Gjatë afshit (kohës para ndërzimit), ka disa shenja çiftëzimi për secilën dhi. Këtu luan me shumë mundësi një rol aroma seksuale. Në praktikë përllogaritet një cja për 50 dhi. Keçat janë mësuar me 30 dhi. Praktikuesit thonë se vetëm cjeptë veçanërisht aktivë nga ana seksuale e spërkasin urinën tek koka, gjoksi dhe këmba. Kjo shërben për të forcuar erën seksuale, e cila nga ana tjetër forcon sjelljen e ardhjes së dhisë në afsh dhe në këtë mënyrë rritet pjelloria.

Kontrolli i ciklit me programin e dritës

Një ritëm i dritës artificiale mund të përdoret gjithashtu për të nxitur afshin jashtë periudhës natyrore. Faktori që nxit aktivitetin seksual është shkurtimi i gjatësisë së ditës. 7-10 javë pas ditës më të gjatë, fillon aktiviteti seksual i dhive. Nëse simulohet një ditë më e gjatë për dhinë me anë të dritës elektrike në pranverë, ato gjithashtu vijnë në afsh rreth 10 javë pas përfundimit të këtyre ditëve të zgjatura artificialisht dhe kalimit në ditën më të shkurtër natyrore. Kapërcimi mund të jetë i papritur, domethënë, ndriçimi artificial fiket nga një ditë në tjetrën. Një kalim më i ngadaltë nuk është i nevojshëm. Nga janari deri në mars, dhinë mbahen në ditë 20 orë në ditë për të paktën

60 ditë. Shkëlqimi i dritës artificiale duhet të korrespondojë me dritën e ditës dhe arrihet me një tub fluoreshent 60 vat për 5m², të montuar 2,75 m mbi dysheme. Nëse ndriçon në janar dhe shkurt, mund të fertilizosh në maj dhe qershor. Megjithatë, periudha e afshit është e shkurtër dhe e vështirë për t'u zbuluar, kështu që në mënyrë sa më të përshtatshme duhet të vrapojë edhe cjapi së bashku me dhinë. Cjeptë gjithashtu duhet të ndriçohen dhe të ushqehen mirë në mënyrë që të çiftohen jashtë sezonit normal.



Për më thjesht, dhitë në kope mund të mbahen në dritë artificiale, por në pranverë çiftohen vetëm aq sa nevojiten për furnizim të vazhdueshëm me qumësht. Rendimenti i qumështit i dhive të pa çiftuara nuk ndikohet nga drita artificiale dhe ato kthehen në afsh (periudha para ndërzimit) normalisht në vjeshtë. Programi i dritës imiton ditët e gjata dhe netët e shkurtra, duke zgjedhur kështu periudhën e dëshiruar të afshit. Në vendet ku prodhimi i dhive bëhet në mënyrë profesionale, puna me programin e dritës është tashmë standarde. Ndër vite milen gjithnjë e më shumë dhi. Përvoja ka treguar se ka deri në 70% të dhive që prodhojnë një rendiment të lartë të qumështit për disa vite, edhe pa mbetur shtatzënë. Shoqata kombëtare ndjek me shumë interes metodat e prodhuesve të suksesshëm të qumështit, duke qënë gjithmonë me dije për metodat e reja të mbarështimit që kontribuojnë në rritjen e performancës.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

8. TË USHQYERIT E DHIVE NËLAKTACION

Përpunuar nga Kristian Maka

Qëllimi i të ushqyerit është plotësimi i nevojave të dhive për energji dhe lëndë ushqyese, në mënyrë që të kenë një performacë të lartë, të jenë të shëndetshme dhe pa probleme. Plotësimi i nevojave për energji, proteina dhe minerale në racionin e ushqimit janë të nevojshme për të siguruar kushte optimale të rritjes për mikroorganizmat e rumenit.

Të ushqyerit sipas fazave

Kapaciteti absorbues i trupit dhe kërkesat për energji ndryshojnë gjatë ciklit të prodhimit të një dhie qumështore. Në mënyrë që dhitë të ushqehen mirë duke mbetur të shëndetshme, duhet të ushqehen sipas fazave të ndryshme të laktacionit. Racioni i ushqimit duhet të përshtatet me nevojat e kafshëve, në mënyrë që dhitë e reja mos rrezikojnë të shëndoshen dhe dhitë me shumë keca mos vuajnë nga sëmundjet metabolike. Nëse situata e fermës dhe madhësia e tufës e lejojnë këtë, duhet të formohen grupe që mund të ushqehen me racione të ndryshme.

Të ushqyerit ndahet në katër faza:

1. Barra e rëndë (ushqyerja përgatitore)

Vitamina A është shumë e rëndësishme për rritjen e kockave dhe lëkurës. Mungesa e saj shkakton hornifikim,

të cilat shfaqen si në lëkurën e jashtme të trupit ashtu edhe në mukozat e brendshme të sistemit të frymëmarrjes, të sistemit tretës, sistemit riprodhues dhe mukozën e syrit. Në këtë mënyrë, lehtësohet depërtimi i mikrobeve patogjenë dhe zvogëlohet rezistenca e kafshës.

Si pasojë e ndryshimeve në mukozën e organeve gjenitale, femrat kanë ndikim negativ në procesin e fekondimit. Gjatë procesit të fekondimit, embrioni ushqehet dobët, gjë që çon në deformime dhe dështime. Përveç kësaj, vitamina A është e nevojshme edhe për metabolizmin e organeve riprodhuese. Tek kafshët meshkuj, ndikon në formimin e spermës dhe cilësisë së saj.

Mangësitë e vitaminës A shkaktojnë osteomalaci (rakitizëm), sidomos te kafshët në rritje, sensibilitet ndaj frakturave, gjakderdhje në indet e trupit dhe degradim të lëkurës dhe mishit të dhëmbëve.

Vitamina D formohet në lëkurë nga efekti i rrezeve diellore UV, ndikuar nga kushtet dritë-errësirë. Kjo vitaminë është esenciale për formimin e kockave dhe fortësinë e thundrave. Një furnizim i mirë me vitaminë D, çon në përmirësim të ardhjes në afsh dhe në përqindje të lartë të barsmërisë. Mangësitë e vitaminës D mund të shkaktohen nga stalla të pandriçuara mirë.

Vitamina E është e rëndësishme për metabolizmin e qelizave. Ajo siguron mbrojtje aktive të qelizave dhe mbrojtje kundër infeksioneve. Është e rëndësishme për pjellorinë dhe formimin e antitropave.

Në ushqimin e deleve dhe të dhive duhet të përdoret premiks pa përmbajtje bakri, edhe pse delet dhe dhitë në laktacion, kanë kërkesë të përditshme për bakër, një sasi prej 15 deri në 30 g. Prandaj duhet të sigurohet një furnizim i saktë me ushqim. Rreziku i përdorimit të premiksit të gjedhit është në dorë të çdo fermeri. Qengjat duhet të mbahen të ndarë dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të konsumojnë nga ky ushqim sepse ekziston rreziku për helmim.

Sipas programit të SHAUMANN për ripërtypësit:

Nga gama e produkteve për gjedhin, rekomandohen për përdorimin e të imtave, produktet si Rindavit Start me përmbajtje bakri 220mg/kg dhe Kalvicin Pro me 280 mg /Kg.

Rëndësia e pjellorisë në rritjen e deleve dhe ndikimi i ushqimit dhe higjienës.

Përgatitjet paraprake për periudhën e ndërzimit ofrojnë mundësi optimale për një pjellje sa më të lehtë.

Ndikimi mbizotërues i performancës së pjellorisë së deleve mbi përfitimet e fermave me dele bëhet i dukshëm sepse diferenca e të ardhurave ndërmjet racave pjellore me numër produktiviteti 172 dhe racave me numër produktiviteti relativisht të ulët 122, është rreth 15.000€ të ardhura për fuqi pune në vit.

Në rritjen e dhenve në Gjermani synohet një numër mesatar produktiviteti prej 130 në të gjitha fermat. Kjo do të thotë 1,3 qingja të rritur për dele.

Sipas „Schlolauf“ mund të supozohet se mesatarja e klasifikimit gjenetik të racave në Gjermani duhet të jetë 1.8 qengja për pjellje. Për racat më pjellore, kjo vlerë është 2,4 qengja për pjellje. Si masë mbështetëse për shfrytëzimin e potencialeve gjenetike është njohja e kohës biologjike optimale të pjelljes dhe të ushqyerit me faza i deleve. Furnizimi i mjaftueshëm i dhenve më ushqim mineral MILLAPHOS Z është në këtë rast i një rëndësie të veçantë.

Në fund të verës para ndërzimit, kur kullotat nuk janë shumë të pasura me ushqim, rritet nevoja për ofrimin e rregullt të ushqimit mineral. Delet janë më të dobta nga laktacioni i mëparshëm dhe duhet të plotësojnë përsëri rezervat. Një organizëm i rregullt mund të krijojë kushtet për një fekundim të mirë dhe një barsmëri pa probleme.

Furnizimi me ushqim mineral MILLAPHOS Z nuk do të ketë probleme në tufat me sistemin automatik të furnizimit RINDAMAT. Masat „të ushqyerit-Flushing-“ (pak para ndërzimit në kullota ose koncentrat) mbështeten nga furnizimi me ushqim mineral.

Përveç rritjes së normave të pjelljeve duhet t'i kushtohet vëmendje edhe rritjes së numrit të produktivitetit, në interes të përmirësimit të të ardhurave të rritjes së dhenve dhe reduktimit të humbjeve të qengjave.

Masat e lidhura me higjienën dhe luftimi i prazitëve të brendshëm kanë ndikim të madh në uljen e humbjeve në mbarështimin e qengjave.

Për qengjat e shëndetshëm duhet furnizim intensiv. Shtimi ditor në peshë rritet në mënyrë të konsiderueshme nëse ofrohet koncentrat, përveç qumështit dhe ushqimit voluminoz.

Vitaliteti i lartë dhe shanset për mbijetesë të lidhura me rritjen e vrullshme të qengjave janë të garantuara kur ushqimi i përdorur përbëhet nga 76% misër, 20 % bërsi soje dhe 4% MILLAPHOS L.

Përzierja minerale dhe koncentrat i aktiv MILLAPHOS L përfshin hulumtimet e reja të Hülseberg. MILLAPHOS L rrit vitalitetin dhe cilësinë e mishit të qengjave në mënyrë ideale.

Nevoja për energji dhe minerale – Dele

Delet	Ca	P	Na	Mg
Përmbajtja (g/kafshë në ditë)	7,5	5,5	1,5	1
Deri në ditën e 90-të të barrës	8,5	6	2	1
Në laktacion, 1 qengj	17	9	2	2,5
Në laktacion, 2 qengja	20	10	2,5	3

Kërkesa për mikroelementë dhe vitamina – Delet

Mikroelementë:

Për çdo kg lëndë të thatë:


- 50 mg hekur
- 8 mg bakër
- 60 mg mangan
- 40 mg zink
- 0,08 mg kobalt
- 0,3 mg jod
- 0,15 mg selen

Vitamina:


Për kafshë në ditë:

- 2.000 - 6.000 I.E: Vitamin A
- 200 - 600 I.E: Vitamin D
- 50 -100 mg Vitamin E

Të gjitha vitaminat e tjera mund të absorbohen gjatë sintezës mikrobiale në rumen, kjo do të thotë që furnizimi nga jashtë nuk është i nevojshëm.



Pesha e uterusit dhe fetusit:



Barrëse e rëndë					
Fetus	Pesha/fetusi	MJ ME	g XP	g Ca	g P
1	3 kg	13	125	9,0	6,0
	5 kg	15	155	9,0	6,0
2	3 kg	15	130	9,0	6,0
	5 kg	19	190	9,0	6,0

Laktacion					
	Kg qumësht/ditë	MJ ME	g XP	g Ca	g P
	1	18	225	10,3	6,0
	2	26	365	15,7	7,7
	3	34	505	24,0	9,6
	4	42	645	26,5	11,4

Për më shumë informacion:



Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

16. KARAKTERISTIKAT E USHQYERJES SË DHIVE TË QUMËSHITIT

Përpunuar nga Dardan Grajçevci

Dhitë karakterizohen nga një ushqyerje shumë përzgjedhëse, kapriçoze. Ato preferojnë ushqim të imët dhe të pasur me gjethe. Struktura dhe shija e ushqimit ndikojnë në konsumin e tij.

Në varësi të llojit të ushqimit, tek dhitë mund të vihet re sa

ushqim kanë lënë tepër në kullotë ose në grazhd. Dhitë janë kapriçoze në ushqim, por përsëri ka disa rregulla.

Ushqimi mund të planifikohet në mënyrë që të merren të gjitha vlerat ushqimore të nevojshme. Cilësia e ushqimit ka një rëndësi të veçantë. Ushqimi i mirë dhe i thatë është çelësi i një ferme ekonomike. Kashta dhe jonxha e mirë nxisin ngrënien, rrisin vlerat ushqimore dhe garantojnë një shfrytëzim optimal të lëndëve ushqimore. Kjo përkthehet në rendiment të mirë të prodhimit të qumështit, më pak koncentrat. Ushqimi i mirë bazë kursen koncentratin.

Ushqyerja në dimër, shembuj të racioneve të thjeshta (lënda e njomë)

Dhi qumështi 60 kg	Muaji i 5-të i shtatzanisë	Muaji i 2-të i laktacionit 5 kg qumësht	Pas muajit të 3-të të laktacionit 3 kg qumësht
Shembull 1	1,0 kg kashtë e mirë 0,45 kg bar shumë i mirë	0,45 kg kashtë e mirë 1,6 kg bar shumë i mirë 0,8 kg koncentrat energjie 0,2 kg koncentrat proteinik	0,3 kg kashtë e mirë 1,6 kg bar shumë i mirë 0,6 kg koncentrat energjie
Shembull 2	0,75 kg kashtë e keqe 0,5 kg bar mesatar 0,25 kg koncentrat energjie 0,1 kg koncentrat proteine	0,6 kg kashtë e keqe 1,0 kg bar mesatar 1,1 kg koncentrat energjie 0,45 kg koncentrat proteinik	0,6 kg kashtë e keqe 0,8 kg bar mesatar 1,0 kg koncentrat energjie 0,15 kg koncentrat protein
Shembull 3	1,25 kg kashtë e mirë 1,0 kg panxhar i bardhë	1,4kg kashtë e mirë 4,5 kg panxhar i bardhë 0,4 kg koncentrat 0,3 kg koncentrat proteinik	1,3kg kashtë e mirë 4,5 kg panxhar i bardhë 0,2kg koncentrat proteine
Shembull 4	0,8 kg kashtë mesatare 1,4 kg silazh bari 0,1 kg koncentrat proteine	0,7kg kashtë mesatare 3,1 kg silazh bari 0,9 kg koncentrat 0,25 kg koncentrat proteinik	0,7 kg kashtë mesatare 2,8 kg silazh bari 0,35 kg koncentrat 0,3 kg koncentrat proteine
Shembull 5	1,25 kg kashtë e mirë 0,7 kg briketa misri	1,25 kg kashtë e mirë 0,7kg briketa misri 0,55 kg koncentrat energjie 0,55 kg koncentrat proteinik	1,25 kg kashtë e mirë 0,5 kg briketa misri 0,7 kg koncentrat energjie
Shembull 6	1,1 kg kashtë e mirë 0,35 kg bar shumë i mirë	0,35 kg kashtë e mirë 1,45 kg bar shumë i mirë 4,5 kg panxhar i bardhë 0,3 kg koncentrat proteinik	0,2 kg kashtë e mirë 1,45 kg bar shumë i mirë 3,9 kg panxhar i bardhë



Në natyrë kafshët e kërkojnë ushqiminnë bazë të instiktit dhe shijes. Për të arritur një rendiment të lartë të prodhimit të qumështit, duhet të shtohet koncentrat.

Sjellja e të ushqyerit

- Sjellje përzgjedhëse
- Preferencë për ushqim të imët me shumë gjethe
- Ngrënie e shpeshtë
- Periudha kohore e ngënies në mëngjes dhe mbasdite herët

Konsumi i ushqimit mund të rritet në qoftëse ushqimi jepet në mëngjes dhe mbasdite, si dhe vënia në dispozicion gjatë ditës. Në fillim duhet t'u jepen ushqimet voluminoze dhe më pas koncentrat.

Konsumi i ushqimit

Për të vlerësuar konsumin e lëndës së thatë (LTH) për dhitë e qumështit mund të përdoret formula e mëposhtme:

$$LT\ H(kg/ditë) = 0,01 \times (\text{pesha } kg) + 0,9 + 0,4 \times (kg \text{ qumësht} - 1)$$

Në dy muajt e parë të laktacionit, vlera e përllogaritur duhet të reduktohet me 10-15%.

- Për çdo rritje peshe prej 10 kg, konsumi i lëndës së thatë duhet të rritet me 100 g.
- Për çdo kg qumësht shtesë duhet të shtohet 400 g më shumë lëndë e thatë.

Për shkak të përmbajtjes së ulët të vlerave ushqimore të qumështit të dhisë, supozohet se dhitë kanë një nevojë relativisht të ulët për energji dhe proteina.

Këshilla ushqimi për dhitë e qumështit

Faza fillestare: Muaji i 1-rë dhe i 2-të i laktacionit.

Karakteristika:

- Prodhim i lartë qumështi
- Nevojë më e lartë për vlera ushqimore dhe minerale (50 deri në 75% më shumë se gjatë shtatëzanisë)
- Konsumi i ushqimit reduktohet me 10-15%, pasi ngrënia e ushqimit rritet më ngadalë se sa nevoja për vlerat ushqimore.
- Shpërbërja e rezervave trupore kur prodhimi ditor shkon mbi 3 kg, rënie prej 8 kg në peshë
- Probleme të mundshme: acetonemia, temperaturë e lartë.

Rregullat e të ushqyerit:

Me anë të cilësisë së ushqimit dhe teknologjisë së ushqyerjes duhet të arrihet një konsum sa më i lartë i ushqimit, në mënyrë që deficieti i energjisë të mbahet sa më i ulët të jetë e mundur.

- Përdorimi i ushqimit të mirë (bar, panxhar, etj)
- Koncentrat në doza të shpërndara gjatë ditës
- Doza e koncentratit duhet të rritet me rreth 200 g çdo javë, në mënyrë që të shmangen problemet me tretjen.
- Vënia e vazhdueshme e ushqimit në dispozicion rrit konsumin e ushqimit
- Racionet ushqimore me komponentë të ndryshëm (p.sh.kashtë, silazh bari, panxhar i peletuar) rrisin konsumin e ushqimit

Përbërja e ushqimit				
Ushqimi	Cilësia	% LTH	NEL MJ /kg LTH	APD g/kg LTH
Kashtë e mirë	A 2-4	88	5,4	86
Kashtë mesatare	A 2-5	88	5,0	78
Kashtë e keqe	A 2-7	88	4,4	65
Bar shumë i mirë	A 2-2	88	5,9	199
Bar mesatar	A 2-4	88	5,4	86
Koncentrat energjitik		87	8,0	100
Koncentrat proteinik		87	8,0	240
Koncentrat prodhimi		87	7,5	125
Panxhar i freskët		19	7,4	85
Silazh bari		35	6,4	84
Misër kokërr		90	6,3	85

Sistemet e ushqimit dhe mbarështuesit e dhive

Forma e mbajtjes	Avantazhe	Disavantazhe
Në fermë me ushqim të freskët (të gjelbër)	Ushqyerje e rregullit, humbje të vogla ushqimi, problem i reduktuar i parazitëve	Shumë punë dhe makineri
Në kullota: kullota "evergreen"	Pa ndarje Më pak punë	Ushqim jo i rregullit, humbje të ushqimit, rreziku i tejngrënies, problem me parazitët
Kullota me rotacion (me shumë parcela)	Pak a shumë ushqyerje e rregullit, rrezik i ulët tejngrënies	Punë për zhvendosjen e ndarjeve, problem me parazitët
Kullota me porcion (intensive me procione ditore të freskëta)	Ushqim i rregullit, humbje të ulëta, rrezik i ulët tejngrënies	Shumë punë për ndarjet, probleme me parazitët
Të lira	Pak punë	Prodhim u ulët, ushqyerje e keqe

Faza e prodhimit: Muaji i 3-të dhe i 4-rt i laktacionit

Karakteristika:

- Periudha e ngrënies së ushqimit bazë
- Marrje maksimale e ushqimit
- Nevoja për vlerat ushqimore mbulohet nga ushqimi bazë
- Krijimi i rezervave (rezervat trupore të shpërbëra gjatë periudhës së fundit të laktacionit rigjenerohen)

Rregullat e ushqimit:

- Ushqimi i mirë bazë kursen koncentratin
- Mbulim pa problem i nevojave
- Konsum maksimal i ushqimit me ulje të prodhimit të qumështit

Mos ushqeni së tepërmi kafshë, të cilat prodhojnë pak qumësht gjatë përfundimit të laktacionit. Kafshët e shëndosha kanë lindje të vështira dhe prodhim të pamjatuështëm të qumështit në fillim të laktacionit.

Faza e riprodhimit dhe përgatitjes

Muaji i tretë i shtatzanisë e deri në lindje

Karakteristika:

- Rritje e shpejtë e fetusit
- Rritje e nevojës për vitamina dhe minerale për shkak të shtatzënisë me rreth 40-100%.
- Rënie e konsumit të ushqimit (vëllim i kufizuar i stomakut)
- Përgatitje për laktacion

Rregullat e ushqimit:

- Ushqim bazë i mirë (mbi 5,5 MJ NEL/kg LTH)
- Furnizim i mirë me vitamina dhe minerale

- Futja e ngadaltë e koncentratit për përgatitje për laktacion (fillimi: 6 javë para lindjes, përshtatje me racionin e dy muajve të parë të laktacionit)
- Sasia e koncentratit në periudhën e lindjes 200-300g për ditë për të parandaluar problemet me metabolizmin e karbohidrateve.

Ushqimi i dhive të qumështit në dimër

E rëndësishme: furnizim i mjaftueshëm me minerale dhe ujë të freskët

Ushqimi në verë - kullota

Teknologjia e kullotave:

- Rregullim i ngadaltë i ushqimit, mikroorganizmat kanë nevojë të përshtatën për 1-2 javë
- Fillimi i kullotjes herët (shumë ushqim në dispozicion)
- Zmadhimi i sipërfaqes së kullotës në vjeshtë
- Kohë e gjatë qetësie

Kullota të mbyllura:

- Përshtatja e madhësisë së kullotës në varësi të kafshëve
- Max 1 javë kohë kullotjeje për kullotë
- Të paktën 5 kullota
- 3-5 javë kohë pritjeje për kullotë

Mineralet:

- Në zona maloreshpesh ka mungesëP
- Në zona kodrinoreshpesh ka mungesëCa
- Blloqe kripe (Na)
- Elektrolite(>50 mg për çdo kg peshë): Ca, P, Mg, K, Cl, S
- nMikroelementë (< 50 mg për çdo kg peshë): Fe, Cu, Mn, Zn, J, Co, Se, Mo, Cr
- Bllok kripe dhe minerale, ose në formë pluhuri, duhen përzierë me koncentratin.

Rritja e kecape

Dhitë mbahen kryesisht për prodhimin e qumështit. Për këtë arsye, pas lindjes, kecat ndahen nga nëna e tyre. Duhet pasur shumë kujdes, që kecat e porsa lindur të pijnë kulloshtërën sa më shpejt. Deri në ditën e 4-rt ata duhet të pijnë kulloshtërën e pasur me vitamina dhe antitrupe. Për të qenë me eficientë ekonomikisht, është mirë që gjatë periudhës së pirjes së qumështit, qumështi i dhisë të zëvendësohet me qumësht pluhur, i cili kushton më pak. Duke e ushqyer që herët me lëndë të thatë, përshejtohet zhvillimi i stomakut ripërtypës. Pra, pas javës së tretë, ushqimi dhe uji duhet të jetë lirisht në dispozicion. Temperatura e pirjes duhet të mbahet patjetër 40° C.

Ushqimi i dhive të vogla femra

Pas ndërprerjes së qumështit (rreth 8 javë pas lindjes), dhitee vogla duhet të marrin 300 g koncentrat, për të garantuar një rritje të njëtrajtshme. Racioni i koncentratit, më pas duhet të reduktohet gradualisht. Në qoftë se ushqimi bazë është cilësor, në muajin e pestë nuk ka më nevojë për koncentrat. Në muajin e 7-të, dhia duhet të ketë një peshë prej 35 kg, në mënyrë që të inseminohet.

Ushqimi i kecase meshkuj

Përveç periudhës së pjekurisë seksuale, nevojapër vlere ushqimore është e ulët, në qoftë se cilësia e ushqimit është e mirë, nuk është e nevojshme të shtohet koncentrat. Gjatë kohës pjekurisë seksuale, konsumi i ushqimit dhe nevoja për vitamina dhe minerale rritet, kështu që gjatë kësaj periudhe duhet të shtohet edhe koncentrat (300 g).

Kufizime të ushqimit

- Bërsi molle, deri në 0,9 kg LT (lëndë e thatë) për ditë, e freskët ose si silazh, kujdes cilësinë.

- Lakra: max 0,5 kg LT në ditë, jo për keca pasi i dëmton dhe ndikon në shijen e qumështit
- Panxhar i freskët: deri në 0,7 kg LT në ditë, vetëm panxhar të mirë dhe të konservuar mirë, të prerë në copa.
- Drithëra: preferohen elbi dhe tërshëra, të shtypura ose të grira
- Bar: deri në 1,9 kg në ditë, silazhvetëm me cilësi të mirë dhe plotësoni racionin me kashtë
- Tërshërë jeshile: 0,5 - 1,0 kg në ditë, përzierjeme kashtë
- Patate: deri në 0,6 kg në ditë, jo patate jeshile ose që kanë çelur (diarre, ekzema), të shtypura hahen më mirë sesa të copëtuara
- Silazh misri: mundësisht vetëm në gjysmën e parë të laktacionit, plotësimme 0,5 kg LT kashtë
- Gjethë: deri në 0,5 LT për ditë, shpesh janë të pasur me vitamina dhe minerale
- Hirrë vetëpër dhite e rritura, (jo për keca): deri në 4,5 litër në ditë, Gjethë panxhari: deri në 0,5 kg LT në ditë me kashtë,
- të freskët ose të silazhuar, përmbajtje të lartë proteinike dhe fibre.

Shembuj racionesh për keca për qumësht dhe majmëri.

Mosha	Qumësht pluhur Në ditë	Qumësht dhie Në ditë
Deri në 4 ditë	2 x 750 g kulloshtër	2 x 750 g kulloshtër
5-7 ditë	2 x 750 g përzierje (1/2 kulloshtër, 1/2 qumësht pluhur)	2 x 750 g kulloshtër
Javën e dytë	2 x 750 g	2 x 750 g
Javën e tretë	2 x 800 g	2 x 1000 g
Javën e katërt	2 x 800 g	2 x 1000 g
Javën e pestë	2 x 600 g	2 x 800 g
Javën e gjashtë	1 x 300 g	2 x 700 g
Javën e shtatë		1 x 300 g
Javën e tetë		

Për më shumë informacion:



QF Qendra e Formimit
PB Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

17. QUMËSHTI I SË ARDHMES VJEN NGA DHIA

Përpunuar nga Dardan Grajçevci

Qumështi i dhisë është një ushqim me vlera, i sofistikuar dhe po merr përsëri rëndësi përmes tendencave të reja të ushqyerit, siç janë "prodhimi natyral" dhe "prodhimi i shëndetshëm". Ai është ndoshta qumështi i parë që është konsumuar. Qumështi i dhisë dhe nënproduktet e tij janë të rëndësishme, veçanërisht në vendet e Mesdheut, Zvicër dhe Francë. Qumështi i dhisë ka vlera shumë të mira ushqyese. Djathi dhe qumështi i dhisë shpesh ofrohen në dyqanet "Gourmet", me një cmim që justifikon cilësinë.

Vlerat terapeutike të qumështit të dhisë janë të njohura që në kohërat e lashta. Paracelsus e përshkroi qumështin e dhisë si një qumësht me veti shëruese. Në shekujt XVII dhe XIX, në Bavari, hira e freskët e qumështit të dhisë konsiderohej si një pije shumë e shëndetshme për mëngjes.

Në Azi dhe vendet juglindore të Evropës, qumështi i dhisë dhe hira konsideroheshin ilaç për sëmundjet e mushkërive dhe konsumoheshin për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme.

Vlerat ushqyese të qumështit të dhisë

Qumështi i freskët i dhisë i racave të pastra është i plotë, pak i ëmbël dhe aromatik.

Qumështi i dhisë është ekuivalent me qumështin e lopës, por është akoma më i pasur me vitaminë A, kalcium dhe fosfor.

Përbërja e qumështit (lëndë e thatë)

3.7% Yndyrë
3.3% Proteina
4.5% Karbohidrate (laktozë)
0.8% Kripëra minerale
87.7% Ujë
12.3% Lëndë e thatë

Përmbajtja e minerale në qumësht (mg / 100 ml)

	DHI QUMËSHTI	LOPË
Kalcium	123-151	118
Fosfor	98-122	95
Kalium	153-240	140
Natrium	38-56	58
Magnez	12-21	12
Klorur	121-204	104

- I pasur me kalcium, fosfor, kalium, klorur (i rëndësishëm për formimin e kockave, dhëmbëve, hormoneve dhe vitaminave) ai përmban shumë mikroelementë si p.sh. jod.
- Acidet yndyrore janë thelbësore për oksidimin e qelizave (acidi linolenik dhe acidi arakidonik), sepse trupi i njeriut nuk i prodhon vetë.
- Vitamina A vjen e gatshme në qumështin e dhisë dhe e tejkalon vlerën e vitaminës së karotenit që përmban qumështi i lopës. Për këtë arsye, ngjyra e qumështit të dhisë, gjalpë dhe djathit është e bardhë.
- Qumështi i dhisë përmban më shumë acide yndyrore me zinxhir të shkurtër, prandaj është edhe më i lehtë për t'u tretur.
- Kazeina (proteina) është e strukturuar ndryshe (krahasuar me qumështin e lopës), kjo e bën gjizën të butë dhe delikate.
- Këshillë: Për një pjatë të thjeshtë mund të përgatisni gjizë dhe me erëza të freskëta (nuk keni nevojë për salcë kosi - kështu ulni sasinë e kalorive).
- Vlerat e vitaminës B6 dhe vitaminës B12 janë më të ulëta se në qumështin e lopës, por në sasi të barabartë ose dy herë më të lartë se në qumështin e gjirit.

Dieta Ushqimore

Veçoritë e qumështit të dhisë dhe nënprodukteve të tij:

- Ushqim për foshnja. Qumështi i dhisë është shumë i ngjashëm në strukturë me qumështin e gjirit
- Ushqimi i shëndetshëm dhe dietik
- Qumështi i dhisë shpesh mund të ndihmojë në alergjitë ndaj qumështit të lopës
- Ushqim delikat
- Qumështi i dhisë dhe produktet e tij, djathi, gjizë, kos, hirë, qumësht i thartë, kefir, gjalpë
- Djathi dhe qumështi i dhisë në ditët e sotme konsiderohen si ushqime të zgjedhura, të cilat blihen nga konsumatorët me të ardhura më të larta
- Asnjë kafshë tjetër nuk është aq e zgjedhur në përzgjedhjen e ushqimit, si dhia (gustatorja)

A e dini se?

- *Qumështi i dhisë është qumështi më i pasur në mikroelementë dhe minerale.*
- *Qumështi i dhisë në SH.B.A dhe në Afrikën e Jugut shitet si ushqim i konservuar për fëmijë.*
- *Djathi i dhisë për shkak të sasisë së vogël të yndyrës është lehtësisht i tretshëm, për këtë ka vlera të larta dietike.*
- *Njerëzit në botë pijnë më shumë qumësht dhe sesa qumësht lope.*

Qumështi i dhisë dhe shëndeti jonë

Ndërveprimi i përbërësve e bën qumështin e dhisë një eliksir, i cili mban trupin tonë në formë, forcon qelizat dhe i mbron ato nga ndikimet mjedisore dhe nga një numër sëmundjesh.

- Konsumimi i rregullt i qumështit të dhisë çon në uljen e çrregullimeve nervore
- Pasojat e stresit, gjendja e ankthit, si dhe çrregullimet me përqendrimin mund të tejkalohen. Kjo është arsyeja pse shkencat ushqyese zvicerane theksojnë vazhdimisht: qumështi i dhisë është një pije ideale për mëngjes për fëmijë dhe të rritur, për forcën fizike, mendore dhe shpirtërore të nevojshme në jetën e përditshme.
- Qumështi i dhisë mund të luftojë gjithashtu sëmundjet e lëkurës. Në shumë klinika dermatologjike, në vendet gjermanishtfolëse qumështi i dhisë është masazhuar në lëkurë për të luftuar acarimet e lëkurës dhe skuqjet serioze të saj. Meshkujt mbi moshën 50 vjeç shumë shpesh shfaqin njolla të kuqe në gjoks, të cilat kanë vështirësi për t'u larguar. Me anë të aplikimit të qumështit të dhisë, problemi mund të kontrollohet me kalimin e kohës. Kjo arrihet me terapi të brendshme dhe të jashtme: qumështi i dhisë pihet dhe masazhohet në lëkurë.
- Pirja e rregullt e qumështit të dhisë ka një efekt pozitiv për stomakun dhe për tretjen. Çrregullimet e tretjes mund të eliminohen.
- Në shumë raste, qumështi i dhisë është një ilaç ideal shtëpiak kundër neurodermatitit.
- Përmirësime ndodhin edhe te azmatikët.
- Dr. Helga Sarkisyanz-Heuer nga Ketsch raporton terapi të suksesshme te pacientët me kolit.

Qumështi i dhisë si mbrojtës nga kanceri

Ekzistojnë aludime se qumështi i dhisë në të ardhmen mund të luajë një rol të rëndësishëm në parandalimin e kancerit. Rezultatet e para, pas disa vitesh kërkimi në nivel ndërkombëtar kanë vënë re procese biologjike interesante.

E gjitha filloi në Bashkimin Sovjetik: u vërtetua se një dhi nuk mund të marrë kurrë kancer. Studimet e hollësishme të qelizave e vërtetuan atë. Duhet të ketë diçka në organizmin e dhisë që i bën qelizat e saj më rezistente ndaj kancerit.

Këto gjetje u studiuan në Gjermani nga një shkencëtar: mjeku Prof. Dr. Karl-Heinz Wagner nga Universiteti i Giessen. Ai filloi një seri kërkimesh së bashku me mbarështuesin e dhive „Kurt Brandenburg“ nga Ulrichstein në Central Hesse.

Ata donin të provonin hap pas hapi efektin e qumështit të dhisë në organizmin e njeriut. Pacientët me kancer pinin qumështin e dhisë në një ritëm të rregullt dhe ndiheshin shumë mirë. Eksperimente të ngjashme në Francë treguan se rreziku i rikthimit të sëmundjes te pacientët me kancer që i ishin nënshtruar operacionit ra me shpejtësi për shkak të kurave me qumësht dhie.

Rezultatet e eksperimenteve me minjtë që vuajnë nga kanceri në SHBA dhe Gjermani janë gjithashtu interesante:

- Kafshët ushqeheshin me qumësht të freskët dhie dhe një koncentrat të përbërë nga qumështi i dhisë.
- Efekti ishte befasues: simptomat e sëmundjes u ulën dita ditës.

Kërkuesit në fushën e mjekësisë sigurisht që nuk dalin në përfundimin se qumështi i dhisë një ditë do të përdoret kunder kancerit, por përfundime konkrete mund të nxirren:

- Përbërësit e qumështit të dhisë kanë treguar se kanë një efekt rigjenerues dhe rivendosës të qelizave.
- Qumështi i dhisë, kur konsumohet rregullisht, mbron qelizat tona nga tymi i cigares, toksinat mjedisore, toksinat në ushqim, toksinat që prodhohen në trupin tonë dhe përshpejtojnë procesin e plakjes.

Qumështi i dhisë mund t'i mbajë qelizat tona të reja, t'i gjallërojë dhe rigjenerojë ato.

Sekreti quhet „Ubiquinone 50“

Analizat e sakta të qumështit të freskët të dhisë, nga i cili prodhohet edhe koncentrat medicinal i qumështit të dhisë, kanë treguar që qumështi i dhisë përmban jo vetëm acidin orotik që mbron qelizat, por edhe një grup misterioz përbërësish aktivë, të cilët një ditë mund të jenë çelësi për të kuptuar pse dhitë nuk mund të zhvillojnë kancer.

Përbërës të tillë aktivë gjenden edhe në llojet e tjera të qumështit, por kurrë në këtë përqendrim të lartë dhe kurrë në këtë kombinim të veçantë, komponimesh unike qelizore.

Në qendër të këtij grupi përbërësish është një substancë, e cila në mjekësi quhet "Ubiquinone 50" :

-Ubiquinone është përgjegjës për funksionimin e duhur të metabolizmit qelizor.

-E mban qelizën gjallë më gjatë.

-Ubiquinone 50 është një përbërës me cilësi të lartë që përmban një numër të madh të atomeve të karbonit. Ato veprojnë si substance natyrore mbrojtëse duke aktivizuar qelizat individuale.

-Ubiquinone 50 në qumështin e dhisë është në gjendje të parandalojë, që qelizat njerëzore të bëhen të ndjeshme ndaj sëmundjeve dhe/apo të vdesin para kohe.

Kjo do të thotë që qumështi i dhisë mund të rekomandohet si geriatrik (Geriatri- shërbimet dhe kujdesi për të moshuarit)

Përdorimi praktik i qumështit të dhisë

Nëse dëshironi t'i jepni organizmit tuaj vrull dhe të mbani qelizat të reja, për të ruajtur sistemin e përgjithshëm imunitar, atëherë së paku duhet të kryeni kura tre ose gjashtë javore me qumështin e dhisë për një interval kohe të caktuar.

- Gjeneroni një fermer dhe pranë jush nga i cili mund të blini rregullisht qumështin ose në dyqanin bio të zonës.
- Pini 1/2 litra qumësht dhe çdo ditë gjatë kurës.
- Nëse njihni një fermer dhe, do të ishte gjithashtu shumë e shëndetshme të pini 1/2 litër hirë dhe ose kos dhe çdo ditë për 14 ditë.
- Nëse nuk arrini të siguronit qumësht ose hirën, atëherë duhet të konsumoni djathë dhe, i cili tashmë ofrohet nga shumë dyqane ushqimore. Konsumoni 100 gram djathë dhe çdo dy ditë për 8 javë, mund ta shoqëroni me lakra të egra dhe me një fetë bukë integrale.

Receta me qumështin e dhisë:

Qumështi i dhisë - një pije plot energji

Në shtëpitë e të moshuarve në Zvicër, banorët janë më vital nga pirja e rregullt e kësaj pijeje energjike:

1/4 litër qumësht dhe i freskët dhe i papërpunuar përziehet me 2 lugë mjaltë. Konsumojeni ngadalë dhe me gllënjka të vogla.

Tortë orizi

Shtoni 1 litër qumësht dhe, 250 gram oriz natyral, pak kripë dhe 50 gr mjaltë. Përzierjen vendoseni në zjarr dhe lëreni të ziejë për 25 deri në 30 minuta. Kur të jetë ftohur, përzierjen 1 gotë të vogël Maraschino si dhe 6 gjethe të zbutura xhelatine, ½ liter pana të rrahur, e miksoni me orizin, masën e formuar e hidhni në një formë dhe e vendosni për 4 orë në frigorifer. Shërbehet në copa të vogla.

Receta me djathë dhe:

Sallatë me djathë dhe

6 vezë të ziera, të ftohura dhe prera në rrathë. Zjeni asparag, priteni në copa të vogla, dhe e përzierjen me vezët. Përzierjen 25 gram djathë të butë dhe me 1/4 litra salcë kosi, pak vaj luledielli, kripë, mjaltë, salcë soje, lëng limoni dhe piper në një mikser. Kjo salcë djathi hidhet sipër asparagut dhe vezëve përpara se të shërbehet. Shërbejeni me 1 fetë bukë integrale.

Sallatë frutash me djathë dhe

250 gram djathë krem dhe, 50 gram majonezë dhe 1 lugë gjelle lëng limoni të shtrydhur përzierhen deri sa të përfitoni një masë kremoze. Më pas shtoni rreth 1/8 litra krem qumështi të rrahur. Ndani në feta 2 mollë dhe 1 portokall, përgjysmoni 300g rrush të zi pa fara. Përzierjen të gjithë përbërësve me kremin e djathit të dhisë, lëreni të qëndrojnë për 30 minuta dhe më pas mund ta shërbeni.

Gjalpë dhe kundër reumatizmit dhe artrozës

Gjalpi i dhisë - për nga natyra plotësisht i bardhë - kishte një rëndësi të madhe si ushqim për njerëzit e varfër në shekullin XIX. Sot vlerësohet nga ekspertët e ushqimit, sepse përmban acide yndyrore të vlefshme, të cilat në përvojën e shumë mjekëve, kanë një efekt pozitiv në funksionimin e mëlçisë. Këto acide janë acidi kaprik, acidi kapril, acidi kaproik, acidi laurik, acidi stearik, acidi palmitik, lecitina dhe cefalina.

Në Zvicër dhe Austri në veçanti, gjalpi i dhisë ka një traditë shekullore.

Stërgjyshërit tanë u tërhoqën nga gjalpi i dhisë në landin Appenzeller. Ata u quajtën Caprisana. Emri ishte i përbërë nga fjalët "Capra"-dhia dhe "Sanare"-shërim.

Në Austri, gjalpi i dhisë, gjatë kohës së monarkisë, në Waldviertler është shitur si ilaç.

Kjo është arsyeja pse gjalpi i dhisë është kaq i vlefshëm.

Edhe Kleopatra e njihnte qumështin e dhisë si një eliksir për shëndetin dhe bukurinë. Ajo e lyente trupin e saj çdo mëngjes me gjalpë dhie. Mjeku grek Hipokrati shkroi shumë raporte në lidhje me qumështin dhe gjalpin e dhisë. Të moshuarit që vuanin nga problemet e këmbëve përdornin gjalpin e dhisë. Si rezultat, pas një periudhe kohore, disa prej pacientëve nuk kishin më nevojë për paterica. Kjo është arsyeja pse në atë kohë quhej "një vaj i mrekullueshëm".

Në shekullin e IV, disa manastire në Itali dhe Francë kishin banjën e tyre, ku trajtimi ishte kryesisht me hirën e qumështit dhe gjalpë dhie.

Në mesjetë murgjit në disa manastire në kantonin zviceran të Appenzell ishin të famshëm për përdorimin e gjalpë të dhisë për të trajtuar dhe kuruar gjymtyrët e dobëta, dhimbjen e shpinës dhe të kockave. Në atë kohë ata gjithashtu folën për "vajin e mrekullueshëm të dhisë. Murgjit përzienin gjalpin e dhisë me bimë/erëza alpine, të cilat kishin një efekt më të madh në nyjet dhe në pjesët e indeve. Bimët/erëzat alpine e përdorura për recetën e gjalpë të dhisë ishin: vaj rozmarine, vaj trumze, vaj dëllinje, rrëshirë dhe vaj dafine.

Këto vajra bimë, sëbashku me gjalpin e dhisë krijuan një harmoni ideale për qëllime shërimi.

Efekti i gjalpë të dhisë, duke iu referuar studimeve të fundit, vjen nga përbërësit aktivë vijues:

- mineralet, kalcium, kalium, magnez, natrium dhe elementët e zinkut dhe fosforit.
- vitaminat B 1, B 2, B 6, kolina dhe biotina,
- një seri fermentesh,
- acidi laktik i vlefshëm dextrorotator,
- një pjesë e lartë e aminoacideve thelbësore dhe të lira, acidi orotik dhe acidi citrik
- yndyra e qumështit është e absorbueshme
- peptide të cilat prodhohen nga një proces i veçantë fermentimi dhe të cilat, së bashku me aminoacidet e lira të përmendura më lart mund të rregullojnë ekuilibrin e ujit në lëkurën e njeriut.

Përbërësit më të rëndësishëm në gjalpin e dhisë janë acidet yndyrore, të cilat arrijnë deri në 84% dhe më i rëndësishmi është acidi karboksilik alifatik. Ekziston një marrëdhënie shumë specifike me të:

shumica e produkteve farmaceutike antireumatike e bazojnë efektivitetin e tyre tërësisht mbi këtë acid, ai është përbërësi bazë në prodhimin e ilaçeve. Efekti i ilaçeve antireumatike rrjedh nga natyra, përkatësisht nga gjalpi i dhisë.

Pacientë me rezultate të shkëlqyera

Rematologët kanë testuar dhe provuar "gjalpin e dhisë Caprisana" në një klinikë mjaft të frekuentuar në „Mülheim an der Ruhr“. Ekziston një raport i detajuar dhe mbresëlënës për këtë përvojë nga kirurgu gjerman Dr. B. Becker; botuar në revistën "Java e Terapisë". Tri grupe të ndryshme pacientësh u trajtuan me gjalpë dhie. Të gjithë vuanin nga sëmundje reumatizmale.

- Në grupin e parë ishin 14 pacientë me reumatizëm të indeve të buta me ndryshime degjenerative të shtyllës kurrizore.
- Në grupin e dytë ishin 36 pacientë me sëmundje degjeneruese të nyjeve të gjurit.
- Grupi i tretë përbëhej nga 20 pacientë me dhimbje të nyjeve pas aksidenteve.
- Këta ishin gjithsej 41 burra dhe 29 gra të moshës midis 20 dhe 69 vjeç.
- Çdo pacient u trajtua 4 herë në ditë, për 4 javë me 5 gram gjalpë dhie, duke u masazhuar. Asnjë ilaç tjetër ose xhel nuk u përdor gjatë këtij trajtimi.
- Janë zhvilluar kontrolle të rregullta mjekësore dhe intervista me pacientët

Rezultati:

Aplikimi i gjalpë të dhisë ishte i suksesshëm për të gjithë pacientët. Kishte një ulje të dhimbjes, lëvizje të përmirësuar dhe ulje të enjtjeve. Nga 70 pacientë të trajtuar, vetëm 11 pacientë treguan një përmirësim të moderuar të gjendjes së tyre, pjesa tjetër tregoi një përmirësim të ndjeshëm.

Parakushtet për efektin e gjalpë të dhisë

Në prodhimin e gjalpë të dhisë sipas metodave aktuale, kombinuar me recetat tradicionale duhet të përmbushen kushte të paracaktuara në mënyrë që gjalpi i dhisë të jetë efektiv:

§ Qumështi duhet të vijë nga dhinë që rriten në kullota natyrore, të lira.

§ Atyre nuk duhet t'u jepen shtesa ushqimore, concentrate ose shtesatë hormoneve.

§ Livadhet në të cilat kullosin dhinë duhet të furnizohen me ushqim bio-dinamik.

Përdorimi praktik i gjalpë të dhisë

Nëse vuani nga dhimbje reumatizmale, artrozë, ndryshime patologjike në kocka, nyje dhe ligamente, nëse keni probleme me shtyllën kurrizore ose dhimbje të shpinës, nëse këmbët tuaja janë të tendosura pas ushtrimeve dhe keni dhimbje muskujsh, përdorni gjalpë dhie 4 herë në ditë.

- Versioni klasik është gjalpë dhie Caprisana me bimë/erëza alpine.
- Ekzistojnë edhe preparate të tjera si p.sh. shampo me qumësht dhie, banja me qumësht dhie, sapun me hirin e qumështit të dhisë.

Ju mund të blini gjalpë dhie në farmaci dhe dyqane ushqimore.

Referenca:

Informacioni në Gjermani nga mjeku Prof. Dr. Karl-Heinz Wagner nga Universiteti i Giessen.

Informacioni në Austri: Produktet biologjike të qumështit të dhisë, A-3100St. Pölten. Informacioni në Zvicër: Caprisana-Information, CH-8580 Amriswil.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

18. TË USHQYERIT E DELEVE ME VITAMINA DHE LËNDË MINERALE ME DREJTIM PRODHIMIN

Përpunuar nga Dardan Grajçevci

Lëndët ushqyese si karbohidratet, yndyrnat dhe proteinat, janë të nevojshme për të plotësuar nevojat energjitike për prodhim. Krahas tyre ka dhe shumë lloje të tjera lëndësh ushqimore, të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin e proceseve jetësore si p.sh.: mineralet, vitaminat dhe mikroelementet.

Mineralet

Mineralet klasifikohen në vitamina, mikro dhe makroelemente, të cilat përfshijnë kalciumin, magnezin, fosforin, natriumin, kaliumin, klorin dhe squfurin. Dozimi mesatar është më i madh se 40 mg/kg masë trupore. Nga mikroelementet, 16 prej tyre janë më të nevojshëm ku përfshihen: hekuri, jodi, bakri, mangani, zinku, kobalti, molibdieni, seleni, kromi, zinku, vanadiumi, fluori, silici, nikeli, arseniku dhe plumbi.

Kalciumi, fosfori dhe magnezi kanë pothuajse të njëjtin rol në metabolizëm. Funkzioni i tyre kryesor si lëndë bazë i jep fortësinë kockave dhe dhëmbëve. Aparati skeletor ka nevojë për mineralet për të përballuar ngarkesat mekanike.

Përveç kësaj, makroelementët kanë disa funksione të tjera. Kalciumi aktivizon enzimën e tretjes dhe kuagulimit të gjakut. Kalciumi dhe magnezi janë gjithashtu të nevojshëm për nxitjen e nervave dhe kontraktimin e fijeve muskulare. Fosfori, i cili në trupin e kafshëve gjendet vetëm si acid ortofosforik, është i nevojshëm për prodhimin e enzimave dhe për këtë arsye ka një rëndësi për funksionet jetësore. Fosfori luan një rol thelbësor në transferimin dhe ruajtjen e energjisë ATP.

- Kalciumi dhe fosfori mund të shfrytëzohen në mënyrë më efektive nëse merren në një raport të duhur me njëri-tjetrin. Për delet raporti optimal është 1,5:1 deri 1,9:1.
- Magnezi- përmbajtja natyrale në ushqimin bazë shpesh herë nuk është e mjaftueshme. Për këtë arsye mund të jetë i nevojshëm një suplement shtesë. Përgjithësisht, ushqimi bazë në ferma ka luhatje të sasisë së magnezit në varësi të origjinës dhe përbërjes bimore. Ushqimet me përbërje bari të njomë kanë një përqindje të ulët të theksuar të magnezit.

- Funkzioni kryesor i natriumit, kaliumit dhe klorit është ai fiziologjik. Këto tre elementë nevojiten për ruajtjen e presionit osmotik të lëngjeve të trupit.
- Hekuri është i nevojshëm në formimin e gjakut. Mungesa e hekurit shkakton uljen e imunitetit ndaj sëmundjeve ose agjentëve të ndryshëm, uljen e marrjes së ushqimit dhe ndikon negativisht në rritje.
- Bakri është një element jetësor për shumë procese metabolike. Delet janë të ndjeshme si nga mungesa e bakrit, ashtu edhe nga teprica e tij.
- Zinku aktivizon shumë enzima dhe në trup gjendet kryesisht i lidhur me proteina. Në mungesë të zinkut, procesi i rritjes së deleve dhe marrja e ushqimit reduktohet. Shenja të dukshme të mungesës së zinkut janë rënia e qimeve dhe ngadalësimi i proceseve të shërimit të plagëve. Tek meshkujt, mungesa e zinkut çon në probleme me fertilitetin.
- Mangani aktivizon shumë enzima. Mungesa e tij sjell një pengim të rritjes, zhvillim jonormal të skeletit, ataksi tek të vegjëlit dhe reduktim të fertilitetit.
- Kobalti është pjesë përbërëse e vitaminës B12. Kjo vitaminë nuk gjendet në burime ushqimore bimore dhe tek delet sintetizohet nga mikroflora e stomakut. Për këtë është e nevojshme të merret si suplement shtesë.
- Seleni mbron dëmtimet e qelizave dhe për këtë arsye ka një rëndësi thelbësore. Delet preken shpesh nga mungesa e selenit. Kjo lidhet njëkohësisht me furnizimin e vitaminës E. Me anë të selenit dhe vitaminës E shmanget mioziti tek qengjat. Përveç kësaj, seleni ndihmon dhe në shmangien e problemeve me rritjen dhe fertilitetin.

Lëndët ushqyese duhet të merren me anë të ushqimit. Vetëm një pjesë e tyre përthithet në aparatën tretës, ndërsa pjesa tjetër del me jashtëqitjen. Furnizimi i deleve me minerale përmes përbërjes së ushqimit nuk mund të garantohet për shkak të luhatjeve të larta të përmbajtjes së tyre në ushqim. Kobalti, mangani dhe zinku ndodhen në sasi shumë të vogla në racionet e kafshëve ripërtypëse.

Vitaminat

Vitaminat janë substanca organike me përmbajtje ushqimore jetike, të cilat përmbajnë azot dhe janë të ngjashme me hormonet. Ato kanë funksione të rëndësishme kontrolluese dhe organizmi ka nevojë për to në sasi të vogla sipas nevojës. Disa prej tyre prodhohen përmes baktereve banorë të zorrëve ose përbërësit e tyre transformohen në formën aktive. Acidet, drita e diellit,

nxehtësia dhe uji i shkatërrojnë vitaminat; ruajtja e ushqimit për kohë të gjatë, silazhimi ose lëndët oksiduese shkaktojnë shpërbërjen e tyre.

Ka dy lloje vitaminash: të tretshme në yndyrë (A, D, E, F dhe K) dhe të tretshme në ujë (C dhe B). Secila nga këto ka një rëndësi të veçantë në varësi të moshës, rritjes dhe intensitetit. Trupi ka nevojë për më shumë vitamina kur ka probleme me metabolizmin, infeksionet, stresin etj. Mungesa ose teprica e tyre shkakton anomali, probleme të organeve, ulje të imunitetit, probleme me rritjen dhe fertilitetin. Mangësitë shkaktohen veçanërisht nga regjimi stallor ose nga ushqimi i përzgjedhur. Të vegjëlit janë veçanërisht të rrezikuar për shkak të rezervave të pamjaftueshme.



Furnizimi me minerale është veçanërisht i rëndësishëm për kafshët në regjim stallor.

Vitamina të rëndësishme janë A, D dhe E. Vitamina A ka një rëndësi të madhe për procesin e shikimit dhe përveç kësaj është e nevojshme dhe për rritjen e kockave. Mungesa e vitaminës A shkakton ashpërsim të sipërfaqes së lëkurës, e cila dallohet jo vetëm në lëkurën e jashtme të trupit por edhe në membranat e brendshme të rrugëve të frymëmarrjes, traktit tretës, organeve gjenitale, si dhe tek sytë. Kështu rritet probabiliteti i depërtimit të agjentëve patogjenëve dhe ulje imunitetit të kafshës. Në qoftë se koncepti arrihet, embrioni nuk mund të ushqehet mjaftueshëm, që shkakton deformime ose abortim.

Vitamina A është e nevojshme për funksionimin e organeve gjenitale. Tek kafshët meshkuj, ndikon në prodhimin dhe cilësinë e spermës.

- Furnizimi me vitaminë A për delet i plotëson nevojat në stinën e verës, ndërsa në ushqimin e dimrit, përqindja në ushqim është në përgjithësi shumë e vogël. Prandaj furnizimi me vitaminën A duhet të zëvendësohet me anë të suplementeve me vitamina dhe minerale. Mangësitë mund të çojnë në dobësimin e kockave dhe rakitizëm sidomos tek kafshët e sëmura, prirje ndaj thyerjes së kockave, hematoma dhe degjenerim të lëkurës.
- Vitamina D krijohet në sasi të vogla në lëkurë për shkak të ndikimit të rrezeve UV, në varësi të raportit të dritës-hijes. Kjo vitaminë është e rëndësishme për formimin e kockave dhe për fortësinë e thundrave. Furnizimi i mirë me vitaminë D çon në përmirësimin e problemeve të riprodhimit dhe sjell ndërzime më të suksesshme.
- Kafshët e kullotave, nevojat për vitaminën D gjatë muajve të verës i plotësojnë. Për kafshët që mbahen në fermë, ose gjatë muajve të dimrit, furnizimi me vitaminë D3 duhet të bëhet më mirë me anë të suplementeve me minerale shtesë në racionet ushqimore.
- Vitamina E është e nevojshme për metabolizmin e qelizave. Ajo krijon mbrojtje të qelizave dhe mbrojtje ndaj infeksioneve, është thelbësore për fertilitetin dhe prodhimin e antitropave. Nevoja për vitaminën E varet nga përbërja e racionit ushqimor.

Përzierjet e suplementeve me minerale për delet.

Shumë fermerë delesh marrin në konsideratë të përdorin përzierje minerale në fermë. Parimisht, mund të thuhet që nevoja për një përzierje të mirë minerale rritet, sa më e lartë të jetë kërkesa për prodhim e kafshëve në varësi të drejtimit të tufës. Faktor tjetër i rëndësishëm është nëse kafshët ushqehen në kullotë apo në fermë dhe cili është ushqimi bazë. Nëse kafshët nuk duhet të prodhojnë qumësht dhe ndodhen në një kullotë të pasura, atëherë furnizimi me përzierje minerale mund të ndërpritet përkohësisht. Por furnizimi me kripëra duhet të garantohet gjithsesi.

Nëse kërkohet nivel i lartë prodhimi i qumështit dhe rritje të ndërzimeve, me kafshë rezistente ndaj sëmundjeve, atëherë furnizimi me suplemente minerale duhet të jetë i vazhdueshëm pa ndërprerje. Gjetja e një suplementi të përshtatshëm për një fermë nuk është e lehtë. Shpesh blihet ajo përzierje minerale që ka shitësin më të aftë ose çmimin më të lirë. Por çmimi më i lirë përmban një risk të madh.

Sa më e lartë të jetë përmbajtja e kalciumit dhe sa më e ulët përmbajtja e fosforit, aq më i ulët është çmimi. Kalciumi është tepër i lirë dhe fosfori çmëndurisht i shtrenjtë, prandaj shpesh përzierjet kanë shumë kalcium dhe pak fosfor. Por, këto përzierje nuk janë të përshtatshme për delet . Në një përzierje të mirë minerale, përqindja e kalciumit dhe fosforit duhet të jetë 17% CA/ 10%P. Raporte të tjera të Ca:P nuk i ndihmojnë delet, por i dëmtojnë. Përzierjet me raporte jo të sakta të lëndëve ushqyese, mineraleve dhe vitaminave mund të sjellin ndërveprime të dëmshme me njëra-tjetrën.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

19. PËRFITIMI EKONOMIK NGA MBARËSHTIMI I DELEVE

Përpunuar nga Kristian Maka

Në cilat pika duhet të fokusohemi?

- Llojet e kafshëve: dele ose dhi
- Lloji i prodhimit ose tregëtimi
- Qumësht, mish, kafshë mbarështimi
- Tregëti me shumicë ose pakicë
- Shërbimet e prodhimit, teknologjia e prodhimit
- Numri i qengjave të rritur, prodhimi i qumështit
- Përdorimi i ushqimit të koncentruar, kohëzgjatja e përdorimit etj.
- Numri i krerëve (madhësia e fermës)
- Kostot fikse

Të ardhurat marxhinale për çdo kafshë të gjinisë femërore

„Dallimet e vogla shtohen nëpërmjet numrin më të madh të elementëve!”

Llogaritjet variante

MQ Qengja në majmëri

MQ+Q Si MQ me 2,6 qengja të lindur

MQ+Ç Si MQ me çmim produkti të rritur me 20 %

MQ++ Kombinim i të dy varianteve

MQ+M Shitja e qengjave në majmëri + e kafshëve mbarështuese


MQ+M+Q Si MQ me 2,6 qengja të lindur

MQ+M+Ç Si MQ me çmim produkti të rritur me 20 %

LM+Z++ Kombinim i të dy varianteve

Të ardhurat marxhinale për çdo kafshë të gjinisë femërore (nënë) sipas varianteve (Euro/krerë dele)

Emërtimi	Majmëri qengji (MQ)	MQ + Kafshë mbarështimi (MQ+M)
Qengja	168,5	121,8
Kafshë mbarështimi	-	91,1
Kafshë të vjetra dhe leshi	7,3	7,3
Performancat variabël	175,9	220,2
Vjelja e stokut	7,0	7,0
Koncentrat, ushqim mineral	40,3	31,2
Shëndeti i kafshës	8,0	8,0
Shtrojë kashte	12,0	12,0
Tarifat, qiraja, krasitja	12,0	16,0
Të tjera	10,0	10,0
Kostot variabël	89,3	84,2
Të ardhurat marxhinale	86,5	136,0



a.

1MQ - Qengja në majmëri

Q - Qengji/Qengjat

b. Ç - Çmimi

c. M - Mbarështimi

Kontributi i të ardhurave nga majmëria e qengjave

„Në cilat kushte mund të konsiderohet një aset kryesor?”

Llogaritja e fitimit financiar nga të ardhurat marxhinale në fitim

Performanca variabël

-Kosto variabël

= Të ardhurat marxhinale, Mbarështimi i kafshëve

- Kostot variabël të ushqimit voluminoz, Përhapja e plehut organik

+ Pagesat direkte nuk përfshihen në të ardhurat marxhinale

= të ardhurat e përgjithshme marxhinale

- kostot fikse ekuivalente me shpenzimet


= Të ardhurat marxhinale, Mbarështimi i kafshëve (Fitim)

Baza e llogaritjes së të ardhurave

Emërtimi	Njësi	40 KF	70 KF	150 KF
Kafshë femra (nëna)	Copë	40	70	150
Fusha/Livadh	ha	8,0	13,0	25,0
Pagesa direkte	€	6.160	10.010	19.250
Deduktime	€	2.750	4.125	5.500
Kosto fikse	€	6.350	9.525	12.700

Kontributi i qengjave në të ardhura nga LW + FW në varësi të variantit

■ 40 krerë ■ 75 krerë ■ 150 krerë



Krahasimet me mbarështimin e lopëve qumështore

„Kur rekomandohet ndryshimi?”

Të ardhurat me 25 ha kullotë: 20 lopë qumështore ose 150 dele

Emërtimi	20 lopë qumështore		150 Krerë (dele femra)		
	Me investim	Pa investim	Majmëri qengji	MQ+ Kafshë mbarështimi (MQ+ M)	MQ + M ++
Të ardhurat marxhinale nga aktivitetet operative Fondet publike	26.393 20.000	26.393 20.000	7.717 19.250	15.132 19.250	27.942 19.250
Të ardhurat e përgjithshme marxhinale	46.393	46.393	26.967	34.382	47.192
Shpenzimet për paga dhe qera	750	750	750	750	750
Të ardhurat e përgjithshme marxhinale minus qira	45.643	45.643	26.217	33.632	46.442
Kostot fikse Investimi	7.036	0	0	0	0
Të ardhurat e krahasueshme marxhinale	38.607	45.643	26.217	33.632	46.442
Kostot fikse ekuivalente me shpenzimet	17.000	17.000	12.700	12.700	12.700
Të ardhura LW+FW	21.607	28.643	13.517	20.932	33.742
Koha e punës e nAK	3.449	3.449	2.242	2.542	3.142
Të ardhura LW+FW/nAK	6,3	8,3	6,0	8,2	10,7

Kërkesat dhe të ardhurat ekonomike për shkëmbimin e 20 lopëve qumështore me 150 dele (25 ha kullotë)

Kafshët nëna	Copë	150
Shndërrimi i hambarit duke përfshirë teknologjinë e mjeljes + Blerja e kafshëve	€	30.000
	€	37.500
Konvertimi i shpenzimeve	€	67.500
-Promovimi i investimeve	€	4.500
-Të ardhurat nga shitja e bagëtive (bagëti)	€	37.600
-Të ardhura nga shitja e kuotave të qumështit	€	30.000
Kërkesat financiare Ndryshimi	€	- 4.600

Përmbledhje:

- ♦ Përfitimi ekonomik varet nga teknologjia e prodhimit, produktet e shitjes, menaxhimi, madhësia e tufës dhe kostot e mundësive për fuqinë punëtore.
- ♦ Prodhimi kryesor fillon vetëm me më shumë se 100 kafshë të gjinisë femërore, prandaj shumica e fermave drejtohen duke funksionuar si veprimtari dytësorë.
- ♦ Tregëtia e deleve me shitje të kafshëve mbarështuese konkurruese kundrejt prodhimit të qumështit me nevoja investimi.
- ♦ Kostot e ulta të konvertimit.

Për më shumë informacion:



QF Qendra e Formimit
PB Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

20. VLERËSIMI I KARAKTERISTIKAVE TË MBARËSHTIMIT TË DELEVE DHE DHIVE

Përpunuar nga Kristian Maka

Vlerat e mbarështimit kanë qenë prej kohësh një pjesë integrale e praktikës së mbarështimit të gjedhëve dhe derrave. Nga viti 2017 ka patur edhe një vlerësim modern të mbarështimit për delet dhe dhitë. Mbarështuesve u sigurohet një mjet i rëndësishëm për të lehtësuar përzgjedhjen e kafshëve më të mira nga pikëpamja e mbarështimit.

Karakteristikat e mbarështimit të një kafshe synojnë të vlerësojnë prirjet e saj trashëgimore. Testi i performancës formon bazën për vlerësimin e mbarështimit, ku ndikimet mjedisore (p.sh. menaxhimi i tufës, mosha) korrigjohen me llogaritje. Përveç performancës së kafshës, merret parasysh edhe informacioni mbi prejardhjen.

Mbarështimi mund të vlerësohet për një shumëllojshmëri të gjerë tiparësh nga dy burimet e informacionit, performanca dhe prejardhja. Si rregull, vlerat më të larta të tipareve të mbarështimit duhet të konsiderohen si të dëshirueshme. Duhet të theksohet se vlerat e mbarështimit janë të krahasueshme vetëm brenda racës.

Karakteristikat e mbarështimit monitorohen dhe vlerësohen dy herë në vit (janar, qershor), por mund të përditësohen çdo javë (e martë), nëse janë shtuar të dhëna të reja, të rëndësishme (si p.sh. testi i performancës së mishit). Kjo do të thotë se vlerat mbarështimit nuk qëndrojnë konstante për gjithë jetën, nga njëra anë sepse shtohen performanca shtesë në vetë kafshën ose në kafshët e lidhura me to, nga ana tjetër edhe sepse vlerat e mbarështimit krahasohen gjithmonë me popullatën aktuale.

Meqenëse qëllimi i çdo mbarështimi duhet të jetë që brezi i ardhshëm të jetë mesatarisht më i mirë se paraardhësit e tij, niveli i grupit të krahasimit rritet. Kjo rezulton në "zhvlerësimin e vlerave të mbarështimit" - një shenjë se popullsia po zhvillohet në drejtimin e duhur.

Qumështi

Vlerësimi i tiparit të qumështit kryhet për racat e deleve dhe dhive qumështore. Si bazë të dhënash përdoren laktacionet standarde (240 ditë) deri në laktacionin e 8-të.

Laktacioni i parë ndahet gjithashtu në performancën 100-ditore dhe performancën nga dita e 101-të deri në ditën e 240-të.

Vlera e qumështit llogaritet nga vlerat e mbarështimit për sasinë e qumështit, yndyrës dhe proteinave. Në figurë tregohen rendimentet mesatare absolute të qengjave/kecave (femra) të 20 deshve/cjepve sipas vlerës së qumështit duke përdorur si shembull dhinë Saanen. Kecat/qengjat e cjepve/deshve më të mirë japin mbi 100 kg qumësht më shumë për laktacion.




Fig.1: Performanca absolute (rendimenti i qumështit) e kecave femra të 20 cjepve më të mirë dhe më të këqinj, përkatësisht, sipas vlerës së qumështit (dhi Saanen, n = 391).

Mishi

Të dhënat për tiparin e mishit rrjedhin kryesisht nga matjet e muskujve ose matjet e trashësisë së yndyrës me ultratinguj dhe peshat afërsisht 40 kg. Vlerësimi i mbarështimit është bërë për dy grupe racash, përkatësisht delet malore Merinoland (me origjinë nga Gjermania) dhe Jura (me origjinë nga Zvicra), nga ana tjetër për delet e mbarështuara për mish. Vlerat e mbarështimit për shtesën ditore, trashësia e muskujve dhe trashësia e yndyrës kombinohen me vlerën e mishit.

Për performancën e rritjes së një kafshe, jo vetëm disponimi i saj luan një rol të rëndësishëm, por edhe karakteristikat e nënës (veçanërisht prodhimi i qumështit). Prandaj, për këtë komponent gjenetik, është publikuar edhe një vlerë e mbarështimit të nënës për shtimin ditor të peshës.

Struktura trupore

Për maksimizimin e potencialit gjenetik të deleve dhe dhive janë të rëndësishme jo vetëm karakteristikat e prodhimit, qumësht ose mish, por edhe karakteristikat e strukturës trupore që ulin koston.

Tipare të shumta të mbarështimit vlerësohen dhe publikohen gjithashtu edhe ato të strukturës kockore dhe funksionalitetit.

Kurba e laktacionit

Kurba e laktacionit përshkruan rrjedhën e prodhimit të qumështit brenda laktacionit. Një kurbë e sheshtë e laktacionit sugjeron avantazhe për sa i përket të ushqyerit, stresit metabolik dhe fertilitetit. Kur krahasojmë 20 meshkujt më të mirë dhe më të këqij, femrat e meshkujve me performancë të mirë tregojnë sipas vlerës së rritjes së qëndrueshmërisë një rendiment qumështi afërsisht 10% më të lartë në të tretën e fundit të laktacionit.

Numri i qengjave të lindur

Vlerësimi i mbarështimit për numrin e qengjave të lindur ose qengjave të lindur gjallë për lindje të qengjit kryhet për të gjitha racat. Në numrin e lindjeve të qengjave luajnë një rol dy komponentë gjenetikë, prindërit (femra dhe mashkulli). Prandaj, ekzistojnë edhe dy vlera të ndryshme të mbarështimit për secilën nga këto tipare.

Vlera e mbarështimit të drejtpërdrejtë ose mbarështimit të nënës thotë se sa qengja sjell nëna. Vlera e mbarështimit nga babai ka të bëjë me dashin/cjapin, pra nëse ai sjell pak apo shumë qengja/keca. E rëndësishme: Vlerat e mbarështimit për numrin e qengjave/kecave nuk thonë asgjë për numrin total të qengjave në jetë, por vetëm për frekuencën e lindjeve të shumëfishta për qengjin ose kecin. Një vlerësim i mbarështimit do të zhvillohet në vitet e ardhshme për jetën e dobishme ose performancën gjatë gjithë jetës.

Mosha e pjelljes

Mosha e pjelljes është një tregues i zhvillimit dhe pjellorisë së kafshëve të reja dhe për këtë arsye është i rëndësishëm ekonomikisht. Vlerësimi i moshës së pjelljes së qengjit bëhet për delet alpine. Qengjat femra të 20 deshve më të mirë, të racës alpine Tirol lindën për herë të parë, rreth 4 muaj më herët se qengjat e deshve më të këqinj, kjo sipas vlerës së mbarështimit të moshës së pjelljes së qengjit.

Vlera e përgjithshme e mbarështimit

Vlera totale e mbarështimit është një indeks përzgjedhjeje dhe paraqet përkufizimin matematikor të objektivit të mbarështimit.

Me llogaritjen e vlerës totale të mbarështimit, të gjitha tiparet e rëndësishme ekonomikisht për të cilat janë të disponueshme vlerat e mbarështimit kombinohen në një numër sipas të cilit kafshët mund të renditen objektivisht.

Kafshët rrallë trashëgojnë në mënyrë të përsosur të gjitha tiparet, por përmes vlerës së përgjithshme të mbarështimit, dobësitë individuale mund të kompensohen nga forca e tipareve të tjera. Sapo të jetë zhvilluar një vlerësim përkatës i vlerës së mbarështimit, jetëgjatësia merret gjithashtu parasysht në vlerën totale të mbarështimit.

Vlera totale e mbarështimit llogaritet vetëm për ato raca që kanë vlera të mbarështimit të qumështit ose vlera të mbarështimit të mishit përveç veçorive të strukturës kockore, ndërsa për të gjitha racat e tjera vlera e përshtatshmërisë korrespondon me përmbledhjen e të gjitha tipareve (aktuale).

Një peshë prej 50% qumësht dhe 50% strukturë kockore përdoret për delet qumështore, 60% mish dhe 40% strukturë kockore për delen për prodhim mishi dhe 40 % mish dhe 60% strukturë kockore për delet Merinoland. Në dhitë qumështore, tiparet e qumështit dhe tiparet e strukturës kockore vendosen në raportin 60:40 në vlerën totale të mbarështimit.

Duke marrë parasysht të gjitha tiparet (e disponueshme) ekonomikisht të rëndësishme, vlera totale e mbarështimit ndihmon në shmangien e zhvillimeve të padëshirueshme të mbarështimit. Për çiftëzimin individual, nëse është i mundur, duhet t'i kushtohet vëmendje edhe vlerave individuale të mbarështimit.

Përmbledhje

Vlerësimi i karakteristikave të mbarështimit përfaqëson një moment historik të madh në mbarështimin e deleve dhe dhive në Austri. Qëllimi i vlerësimit të mbarështimit është të vendosë një renditje të kafshëve të një popullate sipas vlerës së tyre të mbarështimit. Vlera totale e mbarështimit dhe vlerat individuale të mbarështimit janë mjete të rëndësishme për fermerët për të gjetur kafshët më të mira të mbarështimit dhe për të marrë vendime për çiftëzimin. Me implementim të qëndrueshëm pritet performancë më e lartë gjatë mbarështimit, d.m.th. një qasje ndaj objektivit të mbarështimit.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

21. INFORMACIONE INTERESANTE RRETH DELEVE DHE DHIVE

Përpunuar nga Jon Zeneli

Njerëzimi i ka njohur që në kohët e hershme funksionet e shumta të deleve dhe dhive si furnizuese të qumështit, mishit dhe leshit.

Delet dhe dhitë luajnë një rol themelor edhe sot, në dietën e një pjese të madhe të popullsisë së botës. Në Austri, blegtoria e deleve dhe dhive është rritur fuqishëm, veçanërisht vitet e fundit.

Si mbahen dhitë dhe delet qumështore?

Delet dhe dhitë mbahen në grupe dhe ndihen më komforte në tufë. Në Austri dhitë dhe delet jetojnë më së shumti në stallë. Stalla duhet të jetë e shtruar me shtrojë të thatë dhe të butë. Gjithashtu kafshët duhet të kenë akses me ujë e freskët gjatë gjithë ditës. Në varësi të menaxhimit të fermës, ushqimi ofrohet lirisht gjithë ditën, ose jepet në racione disa herë në ditë. Deleve dhe dhive u ofrohet edhe një zonë për kullotë, për marrjen shtesë të foragjereve të freskëta të gjelbra, në varësi të kushteve të fermës dhe praktikave të menaxhimit. Nuk rekomandohet rritja e deleve dhe dhive në laktacion gjatë gjithë vitit në natyrë për shkak të kushteve klimatike.



Foto: LK NÖ/ Patrizia Reisinger

Foto: LK NÖ/ Patrizia Reisinger



Racioni ushqimor

Në parim, delet dhe dhitë konsiderohen ekonomike dhe pa kërkesa, por kjo nuk vlen pa limit për racat e specializuara të qumështit. Delet dhe dhitë në laktacion japin shumë qumësht me përbërës mjaft të mirë. Prodhi i qumështit nxit organizmin dhe për këtë arsye kafshëve duhet t'u ofrohet ushqim i bollshëm dhe me cilësi të lartë. Ushqimi voluminoz më i mirë dhe më i shijshëm, pra bari, sana, foragjeret e fermentuara dhe kashta, janë baza për ushqim dhe kjo plotësohet gjithashtu nga një përzierje drithi në varësi të rendimentit të qumështit. Dieta e deleve dhe dhive në laktacion është e përshtatur pikërisht me nevojat e tyre për sigurimin e lëndëve ushqyese dhe mineraleve të nevojshme.



Foto: LK NÖ/ Patrizia Reisinger

Foto: LK NÖ/ Patrizia Reisinger



Qumështi

Në mënyrë që një dele ose dhi të prodhojë qumësht, ato fillimisht duhet të jenë barrse. Për këtë qëllim, dashi/cjapi lejohet të kalojë disa javë me delet/dhitë. Pas pesë muajsh shtatëzani ato lindin zakonisht një deri në tre qengja/keca.

Pak para lindjes fillon prodhimi i qumështit në gji. Ndryshe nga lopët, delet dhe dhitë kanë vetëm dy thitha. Në ditët e para pas lindjes, qumështi është i trashë dhe përmban shumë imunoglobulina, të cilat janë vendimtare për sistemin imunitar dhe rrjedhimisht për shëndetin e qengjit. Ky qumësht i parë, i quajtur kolostrum ose kulloshtër, i përket vetëm të sapolindurit. Pas disa ditësh apo javësh, qengjat hyjnë në "dhomën e kujdesit", pra në bokse.

Mjelja kryhet me makineri dhe qumështi mund të përdoret për konsum nga njerëzit. Si rregull, delet dhe dhitë në laktacion milen dy herë në ditë në dhomën e mjeljes. Kjo është një zonë e veçantë në të cilën është instaluar makineria e qumështit dhe qumështi duhet të merret në mënyrë higjienike. Në kohën e mjeljes, pra në mëngjes dhe në mbrëmje, kafshët kalojnë vetë për në zonën e mjeljes, sepse u jepet një përzierje e shijshme drithërash. Procesi i mjeljes duhet të realizohet në kushte plotësisht higjienike. Gjiri gjithashtu kontrollohet dhe pastrohet para mjeljes.

Gjiri masazhohet me lëvizje të rregullta, duke ndryshuar lehtësisht presionin dhe më pas lidhet me makinerinë me anë të pompave të vakuomit. Njerëzit konsumojnë qumështin e kafshëve të shëndetshme, të paprekura më parë nga infeksioni. Pas mjeljes, të gjitha pajisjet që kanë rënë në kontakt me qumështin lahen dhe shpëlahen mirë.



Pas ekstraktimit, qumështi futet në enën përkatëse dhe ftohet menjëherë. Qumështi merret shumë herë gjatë javës dhe dërgohet në bulmetore ose përpunohet në fermë. Në Austri vetëm disa bulmetore janë të specializuara në përpunimin e qumështit të deleve dhe dhive, prandaj shumë ferma e përpunojnë qumështin në mënyrë të pavarur dhe e tregtojnë atë direkt. Disa herë në muaj kryhen analiza laboratorike për cilësinë e qumështit.

Gjatë një viti, një dele ose dhi në laktacion prodhon gjithnjë e më pak qumësht. Për të rritur përsëri prodhimin e qumështit, delet dhe dhitë barrsen sërish. Rreth dy muaj para lindjes së radhës, mjelja ngadalësohet. Delet dhe dhitë në laktacion nuk prodhojnë më qumësht dhe në këtë mënyrë mund ta rimarrin veten dhe të përgatiten për lindjen e ardhshme. Pas lindjes së qengjave/kecave, delja dhe dhia në laktacion japin sërish qumësht, i cili përdoret si ushqim për të sapolindurit dhe për prodhimin e nënprodukteve të tij.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

22. RACAT E DELEVE DHE DHIVE PËR PRODHIMIN E QUMËSHITIT

Përpunuar nga Jon Zeneli

Shumëllojshmëria e racave të deleve dhe dhive, të përshtatura ndaj kushteve të ndryshme klimatike është mjaft e madhe. Racat e deleve dhe dhive në laktacion karakterizohen nga aftësia për të konvertuar në mënyrë efikase ushqimin që konsumojnë, në qumësht. Gjatë mbarështimit, përveç sasisë së qumështit, vëmendje e veçantë i kushtohet cilësisë së tij; përmbajtjes së yndyrës dhe proteinave. Këta përbërës janë thelbësorë për përpunimin e mëtejshëm të qumështit të freskët në produkte të ndryshme.

Racat e deleve qumështore

Delet qumështore japin rreth 400 deri në 600 kg qumësht në vit.

Racat e deleve qumështore në Austri janë delet Lacaune (dele franceze) dhe delet e Frizianisë Lindore. Raca e deleve Krainer Steinschaf u harrua prej kohësh si një dele qumështore, por po përdoret përsëri nga adhuruesit për prodhimin e qumështit.

Racat e dhive qumështore

Dhitë janë shumë të adaptueshme dhe të gjithanshme, gjë që reflektohet edhe në shumëllojshmërinë e madhe të racave të këtyre kafshëve. Dhitë qumështore janë të përshtatshme nga natyra për prodhimin e qumështit. Ato japin rreth 550 deri në 750 kg qumësht në vit.



Foto: LK NÖ/Patrizia Reisinger



austriapraemix



Austria Praemix

www.ap.com.al







Gemsfarbige Gebirgsziege

Dhia e egër e malit është një nga racat e rrezikuara të blegtorisë në Austri. Është një racë dhie qumështore shumë e fortë, me prodhimtari të mirë qumështi. Është ngjyrë kafe e hapur në gështenjë me një shirit të zi, bark dhe këmbë të zeza dhe shenja të zeza në kokë.



Anglo Nubian Ziege

Kjo racë afrikane është e madhe dhe e fortë, me veshë të gjatë të varur. Të gjitha kombinimet e ngjyrave janë të mundshme. Dhia Anglo Nubian ka një rendiment shumë të mirë qumështi, cilësor në përmbajtje, por gjendet rrallë në Austri.

Për më shumë informacion:



Q F Qendra e Formimit
P B Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al


23. MISHI I QENGJIT - MË E MIRA E NATYRËS NGA FERMAT LOKALE

Mishi i qengjit është ndoshta një nga mishrat më delikate. Ai ka një aromë unike, karakteristike, speciale.

Për shkak të vlerave të larta ushqyese jep një kontribut të vlefshëm për një dietë të shëndetshme dhe të ekuilibruar.

100 g mish qengji pa dhjamë përmban mesatarisht vetëm 180 kcal/750 MJ.

75 % Ujë
20% Proteina
4% Yndyrë
1% Minerale,
vitamina



Rreth 150gr mish qengji mbulon kërkesat e rekomanduara ditore në përqindjet e mëposhtme:

Mishi i qengjave është fibroz, i imët dhe me pak yndyrë - kjo është arsyeja pse ai tretet mirë dhe përmban një raport të ekuilibruar të proteinave të cilësisë së lartë, vitaminave dhe mineraleve të rëndësishme. Vlen të përmendet edhe acidi orotik i cili forcon sistemin imunitar.

Proteina	55%
Vitaminë B 12	100%
Niacin	50%
Vitaminë B 6	25%
Vitaminë B 1	15%
Vitaminë B 2	80%
Zink	40%
Hekur	35%

Arsyet pse duhet konsumuar mishi i qengjit

Mishi i qengjit të freskët është gjithmonë i preferuar, lehtësisht i tretshëm, aromatik dhe përgatitet në mënyra të ndryshme. E veçanta e mishit të qengjit është se vjen nga kafshë shumë të reja që janë rritur afër natyrës. Qengjat gjejnë një shumëllojshmëri barërash në kullotë dhe livadhe alpine gjatë verës.

Mishi i qengjit ka natyrshëm një aromë karakteristike të vetën, prandaj rregulli i "më pak është më shumë" zbatohet tek erëzat.

Rozmarina, trumza, sherebela dhe rigoni harmonizohen në mënyrë perfekte me mishin e qengjit dhe i japin origjinalitet pjetës së servirur.

Mishi i i freskët i qengjit i kategorisë së parë duhet të ketë:

- një ngjyrë rozë të fortë, ku bie në sy yndyra e bardhë.
- fibra të lehta yndyre (mermerimi). Kjo i jep mishit aromën e tij karakteristike dhe siguron që ai të mbetet me lëng kur gatuhet.

Butësia e mishit varet nga mosha e kafshës dhe prerja e veçantë. Mishi i shpinës dhe këmbëve tek qengjat e vegjël është më i butë dhe më i imëta sesa mishi i qafës ose shpatullës.

Qengji duhet të qëndrojë i varur për disa ditë. Gjatë kësaj "kohe maturimi" mishi bëhet i butë dhe zhvillon aromën e tij tipike.

Për më shumë informacion:

24. MISHI I QENGJIT - KËSHILLA TË DOBISHME

Përpunuar nga Kristian Maka

Këshilla të dobishme për gatimin e mishit të qengjit

- Gjatë ndarjes në racione, gjithmonë priteni në drejtim të fibrës. Në këtë mënyrë ju pëftoni fibra mishi të shkurtra dhe të buta.
- Përgatisni kotoletat sa më me kujdes, në mënyrë të barabartë, që fijet e mishit mos të shkatërrohen dhe mishi mbetet me lëng.
- Është e rëndësishme ta piqui shpejt. Kjo pjek sipërfaqen, brenda mishi ruan lëngjet dhe shijen e tij të mirë. Më pas ulni zjarrin dhe përfundoni gatimin.
- Gjithmonë marinoni mishin pak para se ta përgatisni. Kur piqet në skarë ose në tigan, këshillohet që mishi të marinohet pasi ta keni kthyer.
- Sa më e madhe të jetë copa e mishit, aq më e ulët duhet të jetë temperatura e skuqjes. Rekomandim: Piqui copën e mishit për pak kohë rreth 180 gradë, më pas përfundoni pjekjen në 120 deri në maksimumi 160 gradë.
- Mishi i qengjit ka më shumë shije kur pjesa e brendshme, në mes të ketë ngjyrë rozë. Mishi i pjekur shumë ose i zier mund të bëhet i ashpër dhe të humbasë shijen e tij të veçantë.
- Mos i shponi dhe as mos i prisni copat e mishit gjatë gatimit, në mënyrë që mishi të mos bëhet i thatë dhe i fortë.

1 Këmba e qengjit

Këmba, pjesa e kofshës, preferohet zakonisht si mish i pjekur. Bërxollat janë specialitet, të cilat janë feta të trasha sa gishti, me kocka thellë brenda në mish.

Biftekët priten në pjesën e këmbëve, më pas piqen në skarë ose në furrë. Kofsha është ideale për shishqebap, e prerë në kubikë ose ragu të imët.

2 Kurrizi i qengjit

Njohësit e ndajnë qengjin në qafë, kurriz dhe ijë. Kjo pjesë jashtëzakonisht e butë është ideale për pjekje të plotë.


Pjesa e pasme mund të pritet në bërxolla të veçanta ose biftekë (pa kocka) për tiganisje ose pjekje në skarë.

Mishi i qengjit ofron një shumëllojshmëri të gjerë prerjesh që mund të përgatiten në mënyra të thjeshta, por edhe dhe të rafinuara, në varësi të shijes suaj.

Pjatat e shijshme mund të përgatiten edhe me prerje të pakushtueshme, si qafa, shtylla ose gjoksi. Jo gjithmonë duhet të jenë të ashtuquajturat "prerje fisnike" si shpina apo këmba.

3 Shpatulla e qengjit

Kjo pjesë universale është më e përshtatshme për gatime të thjeshta, por edhe për pjata ekzotike. Shpatulla mund të piqet si një pjesë e tërë në hell. Kur hiqet, bëhet një pjekje e shkëlqyer, me ose pa mbushje. Ajo është gjithashtu ideale për zierje - d.m.th. për ragu, gulash, zierje - dhe grirje.



4 Gjoksi dhe barku

Këto copa të lira (të pakushtueshme, me pak dhjam janë ideale për t'u grirë, për ragu ose edhe pët t'u zier. Brinjët me mish janë një specialitet i veçantë, përpjekjen në skarë. Gjoksi mund të zihet (i mbushur ose i mbështjellë) ose të piqet.

5 Qafa dhe shtylla

Këto prerje pa yndyrë janë të shkëlqyera për pjekje të ngadaltë ose mund të përdoren për ragu, rizoto dhe grirje.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

25. MISHI I QENGJIT - KËSHILLA PËR GATIM

Përpunuar nga Kristian Maka

Fileto qengji me verë Shiraz dhe qepë të njoma

Përbërësit për 4 persona:

- Fileto qengji me kocka
- 2-3 degë trumzë
- 1/8 l verë (nga receta qepë te njoma me verë Shiraz)
- 5 lugë vaj ulliri
- 3 thelpinj hudhër
- Kripë, Piper

Përgatitja:

- Furra ngrohet në temperaturën 60°C. Filetot e mishit të qengjit marinohen me kripë dhe piper.
- Në një tigan ngrohet vaji dhe skuqen 4 filetot e mishit në zjarr të fortë. Ulet temperatura, shtohet hudhra dhe trumza dhe mishi skuqet derisa të jetë gati (duhen rreth 5 minuta). Mishi duhet të kthehet shpesh dhe mbi të duhet të hidhet yndyra e nxehtë.
- Mishi vendoset në një pjatë, mbulohet me letër alumini dhe lihet të pushojë në furrën e parangrohur për rreth 10 minuta.
- Hiqet yndyra e skuqjes nga tigani. Në të hidhet lëngu që ka lëshuar mishi kur ka pushuar dhe gjysma e verës së mbetur. Më pas lihet të vlijë. Hidhet pjesa tjetër e verës dhe lihet përsëri deri në vlim. Mishi spërkatet me rigon të freskët dhe shërbehet me qepët e njoma me verë Shiraz.

Qepë të njoma me verë Shiraz:

- 3/4 l Shiraz ose Cabernet Sauvignon
- 4 lugë sheqer kaf
- 1/4 l bulion mish qengji
- 16 qepë të njoma, kripë

Vera përziehet mirë fileton e mishit vendoset në zjarr dhe reduktohet deri në gjysmën e sasisë fillestare. Pastrohen qepët e njoma nga bishtat dhe vendosen shkurtimisht në ujë të vluar me kripë. Hiqen nga ena, shpëlaken me ujë të ftohtë dhe lihen të kullojnë. Pasi kanë kulluar vendosen te lëngu i verës me mishin, përziehen dhe lihen sëbashku. Largohen nga ena, kullohen dhe shërbehen në pjatë. Pjesa e verës që mbetet përdoret për të përgatitur salcën.



Role qengji me spinaq

Përbërësit:

- 1 shpatull qengji, pa kocka, rreth 1,20 kg
- 1 Qepë
- 8 thelpinj hudhër
- 2 degë selino
- 2 karrora
- 1/4 l verë e kuqe
- 1/2 l vaj vegjetal
- 1 lugë e vogël mustardë

Për mbushjen:

- 1/4 kg spinaq të freskët
- 1/2 qepë
- 1 lugë vaj
- 1/16 L qumësht
- buke e bardhë
- 1 vezë
- Kripë, Trumzë, Rozmarinë, Mustardë, Vaj

Përgatitja:

1. Për mbushjen pastroni spinaqin, hiqni gjethet nga kërcelli, lajini dhe kullojini mirë. Priteni spinaqin në shiritë të imët. Qëroni qepën, priteni në kubikë të vegjël dhe skuqeni në vaj. Shtoni spinaqin, qumështin dhe lëroni të ziejë për pak kohë. Masën e derdhni mbi copat e bukës dhe e përzieri butësisht. Lëroni përzierjen të qëndrojë për rreth 1/4 orë, më pas shtoni dhe vezën te mbushja e përgatitur.

2. Ngroni furrën në 200°C. Pritini zarzavatet, karrotat, selinonë dhe qepët në copa të vogla, hudhrën grijeni imët. Mishit i shtoni kripë, piper, trumzë, rozmarinë dhe gjysmën e hudhrës së shtypur. Përhapeni mbushjen në mes të mishit.
3. Mbështilleni mishin me pe kuzhine, dhe rregullojeni nga jashtë me kripë, piper, trumzë, rozmarinë dhe hudhrën e mbetur.
4. Mishin skuqeni të gjithë në një tigan me pak vaj, hiqeni nga tigani dhe e lereni mënjanë. Në po të njëjtin tigan kaurdisni zarzavatet e prepra, shtoni verën dhe vajin vegjetal dhe lërinë të ziejnë.
5. Vendoseni mishin mbi perimet dhe piqini në furrën e parangrohur për rreth 50 minuta - here pas here spërkateni mishin me lëngjet e pjekjes.
6. Pas përfundimit të pjekjes hiqni mishin nga tava. Lëngjet e tavës dhe zarzavatet kullojini dhe salcën e përfutur rregullojeni sipas dëshirës me pak mustardë.



Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

26. QUMËSHTI I DELES DHE I DHISË NË DIETËN USHQIMORE

Përpunuar nga Kristian Maka

Përbërësit e qumështit të deleve dhe dhive - cilat janë ndryshimet?

Qumështi i deles dhe i dhisë, kur është i freskët dhe i ftohtë, pothuajse nuk dallon në shije nga qumështi i lopës. Me kalimin e kohës shfaqet një aromë më e rëndë dhe specifike. Përbërësit e qumështit të deles ndryshojnë shumë, në varësi të racës, të ushqyerit të tyre dhe stinës. Pavarësisht luhatjeve, qumështi i deles ka një formulë relativisht të pasur dhe përmban shumë yndyrë dhe proteina. Kjo përbërje i jep kosit qëndrueshmëri dhe rendimenti në prodhimin e djathit është shumë më i lartë krahasuar me qumështin e dhisë. Qumështi i deles nuk përmban nivele më të larta të acidit orotik sesa llojet e tjera të qumështit. Organizmi i trupit të njerëzve të shëndetshëm prodhon mjaftueshëm acid orotik, prandaj nivelet në qumësht nuk kanë rëndësi domethënëse. Qumështi i dhisë është i ndryshëm në shije në krahasim me atë të lopës. Karakterizohet si pak i ëmbël dhe aromatik, për shkak të përmbajtjes më të lartë të acidit kaprik. Duke qenë se qumështi i dhisë nuk përmban karoten, ai ndryshon edhe në ngjyrë. Djathi i maturuar i dhisë nuk është i verdhë, por i bardhë. Proteinat e qumështit të dhisë janë më delikate dhe fine, si pasojë produktet kanë një masë më kremoze. Globulat e yndyrës janë më të vogla, kështu që qumështi nuk është shumë kremoz dhe tretet më lehtë.

Krahasuar me qumështin e lopës, qumështi i dhisë ka dukshëm një përmbajtje më të ulët të kazeinës alfa-s1. Kazeina (proteina e qumështit) njihet si një substancë që shkakton alergji, ndaj qumështi i dhisë tolerohet nga organizmi më lehtë nga disa njerëz sesa qumështi i lopës.

A është qumështi i deles dhe i dhisë i përshtatshëm si alternativë për alergjitë ndaj qumështit të lopës dhe intolerancën ndaj laktozës?

Qumështi i deles dhe i dhisë rekomandohet shpesh si një alternativë për alergjitë ndaj qumështit të lopës. Në parim, të gjitha proteinat e qumështit kanë potencial alergjik. Duke qenë se kafshët janë të ngjashme me njëra tjetrën, shpesh ndodhin alergji të kryqëzuara, që do të thotë se njerëzit që janë alergjikë ndaj qumështit të lopës reagojnë gjithashtu ndaj proteinave të ngjashme (të tilla si ato që gjenden në qumështin e dhisë dhe deles).

Përmbajtja e laktozës në qumështin e deles dhe të dhisë është pothuajse e njëjtë me atë të qumështit të lopës. Qumështi i deles dhe i dhisë nuk është një zëvendësues për njerëzit që janë intolerantë ndaj laktozës. Në të dyja rastet, rekomandohet që në konsultën me mjekun të testohet nëse qumështi i deles dhe i dhisë tolerohet më mirë duke u përdorur në sasi të vogla.

Lëndët ushqyese për 100 g	Njeriu ¹	Qumështi i lopës ²	Qumështi i deles ²	Qumështi i dhisë ²
Energji kJ	291	279	392	281
Energji kcal	70	67	94	67
Proteinë g	1,0	3,3	5,2	3,6
Yndyrë g	4,4	3,8	6	3,9
Laktozë g	6,9	4,7	4,4	4,2
Vitaminë Ag	61	35	43	68
Vitaminë B2 g	40	180	363	150
Vitaminë B12 g	0,05	0,42	0,51	0,07
Vitaminë D g	0,1	0,074	0,2 ¹	0,25
Acid folik g	5,0	8,5 ¹	6 ¹	0,8
Kalçium mg	32	120	198	127
Magnez mg	3	12	20	11
Fosfor mg	14	92	138	109
Zink mg	0,2	0,38	0,48	0,24

1) FAO - FOOD AND AGRICULTURE ORGANIZATION OF THE UNITED NATIONS (2013): Milk and dairy products in human nutrition. Rome: Eigenverlag.

2) Souci, SW., Fachmann, W. und Kraut, H. (2008): Die Zusammensetzung der Lebensmittel - Nährwert - Tabellen. Stuttgart: Med Pharm Scientific Publishers.

Një dietë e ekuilibruar dhe e larmishme përbën bazën e një stili jetese të shëndetshëm. Qumështi i deles dhe i dhisë, falë ndërvëprimit të përbërësve të tyre, është një ushqim me vlera që forcon organizmin dhe e mbron atë nga shumë sëmundje.

Marketingu dhe përpunimi i qumështit

Vitet e fundit, kërkesa e konsumatorëve për produkte nga qumështi i deles dhe i dhisë është rritur. Gama e produkteve të qumështit të deles dhe të dhisë është zgjeruar. Produkti kryesor është djathi, i cili mbetet ende një nga specialitetet më të kërkuar. Përveç djathit, tregtohet edhe qumështi dhe kosi, ndërsa gjalpi më pak. Qumështi i deles dhe dhisë gjen përdorim edhe në produkte kozmetike me cilësi të lartë.

Qumështi mund të tregtohet në dy mënyra:

Nëpërmjet kontratave të furnizimit me një bulmetore ose nëpërmjet marketingut dhe shitjeve të drejtpërdrejta në dyqane ushqimore natyrale dhe gastronomike. Rreth gjysma e qumështit të prodhuar përpunohet dhe tregtohet drejtpërdrejt në fermë.



Qumështi i papërpunuar është një qumësht plotësisht i patrajtuar. Vjen direkt pas mjeljes dhe vetëm ftohet. Këshillohet që qumështi të zihet përpara se të konsumohet.

Qumështi i deles dhe i dhisë pasterizohet dhe homogjenizohet. Gjatë pasterizimit, mikrobet në qumësht vriten duke u ngrohur për një kohë të shkurtër, dhe si pasojë qumështi ka një jetëgjatësi më të gjatë. Përveç kësaj, qumështi shtypet me presion përmes grykave të imta për të zvogëluar madhësinë e globulave të yndyrës në qumësht. Ky proces quhet homogjenizim dhe parandalon kremimin natyral (ngritjen e yndyrës së qumështit).

Qumështi UHT është një qumësht me datë më të largët skadence. Pasterizimi kryhet në temperatura më të larta, në mënyrë që pothuajse të gjithë mikroorganizmat të shkatërrohen dhe të mbahet në temperature ambienti për muaj të tërë.



Megjithatë, shumë nga vitaminat si dhe shija humbasin për shkak të nxehjes. Kosi në thelb është qumësht i fermentuar.

Qumështit i shtohen kulturat e kosit, të cilat e acidifikojnë atë. Kjo rezulton në shijen tipike të thartë dhe rrjedhimisht në konsistencën kremoze dhe të fortë.



Djathi përbëhet nga njëra anë nga lënda e thatë (proteina, yndyra, vitamina dhe minerale) dhe nga ana tjetër nga uji, i cili avullohet pjesërisht gjatë procesit të maturimit.

Në Austri djathi klasifikohet sipas përmbajtjes së ujit në masën e djathit pa yndyrë. Sa më shumë ujë të përmbajë, aq më i butë është djathi. Në të kundërt, sa më pak ujë të përmbajë, aq më i fortë është djathi. Djathi i deles dhe i dhisë ofrohet si djathë i freskët, i butë, gjysmë i fortë dhe i fortë. Aroma specifike e deles ose e dhisë dallohet shpesh te djathi.

Djathi i freskët nuk ka nevojë të kalojë asnjë proces maturimi. Ka një aromë të butë acidike dhe shije të freskët. Ky lloj djathi është shumë i larmishëm dhe po ashtu edhe konsistenca e tij, e cila varion nga i thërrmuar, në kremoz dhe të fortë.

Djathi i butë shpesh trajtohet me kultivim myku ose kultivim të kuq dhe maturohet për dy deri në katër javë. Maturimi i djathit bëhet nga jashtë brenda. Djathi i butë, i maturuar mirë është mjaft kremoz.

Djathi gjysmë i fortë ka konsistencë mesatare dhe një periudhë maturimi nga katër deri në tetë javë.

Djathi i fortë me kalimin e muajve të maturimit krijon një shtresë, e cila arrihet ose nga tharja dhe lyerja me vaj ose nga larja e rregullt me shëllirë. Reduktimi progresiv i përmbajtjes së ujit i jep djathit të fortë një qëndrueshmëri të fortë.



Prodhime kozmetike nga qumështi i deles dhe i dhisë bëhet kryesisht në mënyrë artizanale (hand-made).

Qumështi i deles dhe dhisë ushqen dhe hidraton lëkurën në mënyrë natyrale. Produktet kozmetike me bazë qumështin e deles ose të dhisë mbështesin veçanërisht acidin natyral të lëkurës dhe për këtë arsye tolerohen mirë edhe në rastet e alergjive, neurodermatitit ose psoriazisë.



Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

27. PËRPUNIMI I QUMËSHTIT NË FERMË

Përpunuar nga Kristian Maka

Fermerët që mbajnë lopë, dhi, dele... mund ta përpunojnë dhe tregtojnë qumështin në produkte të ndryshme. Kjo ndodh sepse çdo fermë është e regjistruar si subjekt i biznesit me numrin identifikues NIPT. Si çdo subjekt i biznesit ushqimor, ai i nënshtrohet dispozitave të ligjit për ushqimin.

Siguria ushqimore është një nga parimet më të rëndësishme të të gjitha kërkesave ligjore. Çdo subjekt i biznesit ushqimor duhet të sjellë në treg vetëm produkte të sigurta. Ai është përgjegjës për sigurinë e produkteve në zonën e tij. Produktet duhet të jenë të gjurmueshme. Garantimi i kësaj forme sigurie arrihet nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të një sistemi vetëkontrolli.

Sistemi i vetëkontrollit

"Udhëzues për fabrikat e përpunimit të qumështit në fermë" mund të shërbejë si një ndihmë për krijimin e një sistemi vetëkontrolli.

Udhëzuesi përmban të gjitha kërkesat që duhet të plotësohen:

- Listat kontrolluese për pajisjet e ambienteve
- Modelet për planet e pastrimit dhe dezinfektimit
- Planet e kontrollit të insekteve/parazitëve
- Informacion mbi praktikën e mirë të prodhimit

- Proçeset e prodhimit
- Informacion mbi magazinimin
- Informacion mbi testimin e produktit të përshkruar

Nëse ky udhëzues plotësohet me ndërgjegjie dhe nëse zbatohen masat, atëherë kemi një sistem të mirëfilltë vetëkontrolli.

Në vijim veçojmë dhe shpjegojmë disa pika të rëndësishme:

Kërkesat për ambientet - ruajtja e qumështit

Qumështi duhet të ruhet në dhomën ftohëse derisa të transportohet në dhomën e përpunimit.

Përpunimi i qumështit

Përpunimi bëhet në një dhomë të veçantë të përpunimit - e ndarë me hapësirë nga prodhimi dhe ruajtja e qumështit. Kjo hapësirë anash pajisjes duhet të jetë e konsiderueshme, për të lejuar akses të lehtë dhe hapësirë të mjaftueshme magazinimi. Muret anësore, dyshemet dhe tavanët duhet të jenë të pastër, të dezinfektuar dhe të mirëmbajtur. Zona për pastrimin dhe dezinfektimin e duarve duhet të jetë në një hapësirë të veçantë.

Maturimi i djathit

Ky proces realizohet në një dhomë të veçantë, në kabinete ose kontejnerë maturimi - në varësi të procesit.

Sistemi i ftohjes

Kur bëhet fjalë për higjienën, ftohja luan një rol të rëndësishëm për qumështin dhe produktet e qumështit.

- Qumështi duhet të ftohet gjithmonë në një temperaturë prej 6 °C ose edhe më pak, sa më shpejt që të jetë e mundur. Përfshihet rasti kur qumështi përpunohet brenda katër orëve ose nëse është maturuar paraprakisht gjatë prodhimit të djathit.
- Zinxhiri i ftohjes nuk duhet ndërprerë gjatë transportit të qumështit apo produkteve të tij.

Pastrimi dhe dezinfektimi

Pastrimi dhe dezinfektimi i pajisjeve, mjeteve ndihmëse të përdorura, enëve të përpunimit, makinerive të përpunimit, si dhe të gjitha zonave të punës, duhet të kryhet me agjentë pastrimi dhe dezinfektues të krijuar enkas për këtë qëllim. Pastrimi dhe dezinfektimi kryhen (sipas planit) jashtë orarit të prodhimit dhe shpëlarja me ujë të pijshëm, në varësi të mjetit të përdorur, është shumë e rëndësishme.

Shëndeti dhe higjiena personale

- Të gjithë personat që janë në kontakt me produktet ushqimore duhet të jenë të shëndetshëm. Kushdo që vuan nga të vjellat, diarre ose simptoma të tjera duhet të bëjë pushim.
- Uniforma e veshjes duhet të jetë personale për çdo punonjës, me ngjyrë të hapur. Kapja e flokëve dhe vendosja e një kapeleje është e rëndësishme.

- Higjiena personale është esenciale (Larja e duarve)

Kontrollet e produktit

Produktet e qumështit duhet të inspektohen rregullisht për sigurinë ushqimore dhe kriteret e higjienës së procesit. Në rastin e sasive më të vogla të përpunimit dhe rrezikut të ulët të higjienës, kërkohet me ligj një herë në vit testimi i produktit me rrezikshmëri më të lartë. Specifikimet e sakta, tabela që liston kriteret që duhen ekzaminuar dhe renditja e produkteve sipas rrezikut mund të gjenden në udhëzues. Testimi i produktit kryhet në laboratorë të specializuar. Çertifikatat e testimit të produktit duhen ruajtur. Natyrisht që çdo mangësi e identifikuar gjatë vetëinspektimit, duhet të korrigjohet menjëherë.

Dokumentimi

Për ta bërë sistemin e vetëkontrollit të kuptueshëm për të huajt, duhet të dokumentohen:

- Të dhënat e funksionimit dhe prodhimit (nëse janë të disponueshme)
- Të dhënat për cilësinë e ujit të pijshëm për burim vetjak
- Dokumentet e produktit me argumente kritike kontrolli (p.sh. nga udhëzimet)
- Protokolli i gabimeve
- Checklistat për hapësirat, planin e pastrimit dhe dezinfektimit (plotësim/aktualizim çdo vit), formulari për kontrollin e instekteve/parazitëve në rast nevojë
- Rezultatet laboratorike (analiza e qumështit të papërpunuar, analiza e produktit)
- Rekomandohen regjistrime të vazhdueshme si pjesë e vetëmonitorimit dhe përshkrime të produkteve.



Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

28. RECETA ME DJATHË DELEJE DHE DHIE

Përpunuar nga Kristian Maka

Djathë deleje i skuqur me proshutë dhe sallatë jeshile

Prisni djathin e deles në copa të trasha, vendoseni në një pjatë dhe lëreni në frigorifer për disa minuta.

Sallata jeshile duhet të pastrohet dhe lahet me kujdes. Për marinimin, përzieni uthullën, vajin, kripën dhe mjaltin. Hidhni erëzat dhe kripën tek fetat e djathit dhe i mbështillni me fetat e holla të proshutës. Në një tigan të lyer me vaj, skuqni për pak minuta djathin e mbështjellë në feta nga të dyja anët derisa të bëhet krokant. Përzieni sallatën me përbërësit për marinim dhe rregullojini në pjatë së bashku me roletë e skuqura të djathit. Sallatën jeshile, lakrën dhe pomodorinit mund t'i përdorni për të dekoruar pjatën.

Këshillë:

- Para se t'i skuqni, copat e djathit i vendosni për pak kohë në ngrirje, më pas djathi mbetet më i ngjeshur gjatë skuqjes dhe ruan formën.
- Shërbejeni me ëmbëlsira të freskëta.

Përbërësit:


- 200 g djathë i ngjeshur deleje ose dhie
- 12 fletë sallatë jeshile e freskët

Marinimi:

- 3 lugë gjelle Uthull
- 6 lugë gjelle vaj
- 1 lugë çaji kripë
- 1 lugë gjelle mjaltë

Për dekorin:

- Erëzat e sezonit
- Lakër e freskët
- Pomodorini për koktejl



Kek (Muffin) me çokollatë dhe djathë

Për kekët (Muffins), çokollatën e ndani në copa së bashku me gjalpin dhe treteni ngadalë në zjarr të ulët duke e trazuar. Lëreni të ftohet mirë. Rrihni së bashku me sheqerin, vaniljen dhe të verdhat e vezëve për disa minuta. Hidhni lehtë miellin, pluhurin e pudingut me çokollatë dhe përzierjen gjalpë-çokollatë në përzierjen e vezëve, të ftohur mirë paraprakisht. Vendosni 14 forma për kekët (Muffins) në një tepsi. Hidhni përzierjen në një qese në formë tubi të pajisur me një grykë me vrima të mëdha dhe ndajeni në mënyrë të barabartë në 2/3 e formave të kekëve. Piqini në furrën e parangrohur për rreth 18 minuta në 180°C dhe lërinë të ftohen mirë.

Për mbushjen e djathit të deles, rrihni sheqerin pluhur dhe vaniljen derisa të bëhet krem. Përzierjen shkurttimisht kremin e djathit të deleve me një mikser dore dhe hidhni në qesen në formë konike. Prisni pjesën e sipërme të kekëve dhe mbulojeni pjesën e poshtme me komposto dhe fruta të freskëta të stinës. Hidhni mbushjen e djathit të ëmbël dhe vendosni pjesën e sipërme të kekut. Shërbejeni të zbukuruar me sheqer pluhur dhe copa çokollate.

Përbërësit:

Kek me gjalpë dhe çokollatë:

- 200 g çokollatë e zezë
- 100 g gjalpë
- 100 g sheqer për pjekje
- 1 lugë çaji vaniljeje
- 2 vezë (e verdhë vezësh)
- 50 g miell
- Pluhur pudingu me çokollatë
- 14 forma për kekët (prej letre)

Mbushja:

- 250 ml krem i rrahur
- 2-3 lugë gjelle sheqer pluhur
- 1 lugë gjelle vaniljeje
- 150 g djathë i freskët deleje
- 1 gotë komposto- komposto kajsie, pjeshke, qershie ose fruta të freskëta të stinës



QF Qendra e Formimit
PB Profesional të Blegtorëve

Për më shumë informacion:

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

29. PRODUKTE CILËSORE TË DELEVE DHE DHIVE

Përpunuar nga Kristian Maka

Gutes vom Bauernhof

Programi i cilësisë "Gutes vom Bauernhof", një markë e Dhomës Austriake të Bujqësisë, përfaqëson prodhimin e ushqimit të bazuar në ferma në nivelin më të lartë. Vula u jepet vetëm kompanive të mira dhe të kontrolluara rreptësisht, që përpunojnë lëndët e para të vetë-prodhura me kujdesin maksimal. Konsumatorët janë të sigurt për origjinën, mënyrën e prodhimit dhe cilësinë e ushqimit.

Das Kasermendl in Gold

„Kasermendl in Gold“ është një çmim për djathin dhe produktet e qumështit. Një juri e pavarur ekspertësh gjykon mostrat. Një "Kasermendl in Gold" do të shpërblehet për ata që shpalosin produktin më të mirë në çdo kategori. Çmimet e mëtejshme janë medaljet në ar, argjend dhe bronz në varësi të numrit të pikëve.

GenussKrone Österreich

GenussKrone jep çmime çdo dy vjet dhe nderon produktet më të mira bujqësore në Austrinë e Poshtme. Fermat, që janë fituese të çmimeve dhe që zbatojnë gjithashtu kriteret e sigurimit të cilësisë dhe origjinës i delegohen ceremonisë së çmimit federal me produktet e tyre të suksesshme. Informacione të mëtejshme në: genusskrone.at

AMA Käsekaiser

Çdo vit, djathërat më të mirë në vend vlerësohen me çmimin AMA-Käsekaiser. Dhënia e çmimit AMA-Käsekaiser paraprihet nga një konkurs gjithëpërfshirës, i objektivizuar për të përcaktuar cilësitë më të mira midis të gjitha specialiteteve të djathit. Regjistrimet nga bulmetoret e njohura të djathit nga e gjithë Austria vlerësohen nga ekspertë që degustojnë produktet. Çmimi AMA-Käsekaiser u jepet vetëm fituesve të dhjetë kategorive.

AMA Genussregionen

Vula e re e miratimit të AMA Genuss Region garanton një nivel të standardizuar cilësie dhe origjinë rajonale të gjurmueshme për produktet ushqimore. Në rastin e produkteve të freskëta ose të përpunuara në dyqanet e portës së fermës, fermat AMA Genuss Region tregojnë qartë se nga vijnë lëndët e para. Informacione të mëtejshme në: www.genussregionen.at.



Për më shumë informacion:



QF
PB Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

30. KÄSEMACHERWELT - BOTA E PRODHIMIT TË DJATHIT-

Përpunuar nga Kristian Maka

Heidenreichstein është një qytet i vogël në Waldviertelin veriperëndimor, i rrethuar nga pyje dhe liqene.

KÄSEMACHERWELT shtrihet në një peizazh piktoresk, në të cilin bota e djathit të deles dhe dhisë është kthyer në një eksperiencë për adhuruesit e mëdhenj dhe të vegjël të djathit. Vizitorët mund të përjetojnë nga afër prodhimin e djathrave gjysmë të fortë, të butë dhe atyre kremozë. Gjatë turit, vizitorët do të mund të shijojnë specialitete të ndryshme djathi.



Çdo vit zhvillohen katër evente fikse (hapja, festivali i kopshtit, festivali i vjeshtës dhe Krishtlindjet), të cilat janë një magnet për vizitorët, duke tërhequr mysafirët nga rajoni, por edhe nga vendet në kufi me Austrinë e Poshtme.



Oferta e KÄSEMACHER-WELT përfshin gjithashtu restorantin "Kaskuchl" me një shumëllojshmëri shijesh lokale dhe specialitete të shumta djathi, të cilat kur moti është i mirë mund të shijohen në tarracë ose në kopësht. Një dyqan i pajisur me produkte të përzgjedhura me shumë kujdes nga rajoni, zona të brendshme dhe të jashtme me lojëra për fëmijë, si dhe mundësi për fëmijë që të përkëdhelin kafshët e fermës e plotësojnë akoma më shumë ambjentin.



Për më shumë informacion:

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

31. FERMA E DHIVE MANDL

Përpunuar nga Kristian Maka

Çdo vizitor në fermën e dhive MANDL, në Bucklige Welt do të kalojë një eksperiencë mbresëlënëse, duke shijuar më të mirat e natyrës dhe duke u njohur me përvojën e shkëlqyer të mbarështimit të dhive.

Vizitorët mund të shohin nga afër jetesën e dhive dhe përpunimin e qumështit në një gamë djathërash dhe të vlerësuara me shumë çmime.



Në fermën e dhive të Mandl, vizitorët do të përjetojnë jetën e përditshme të dhive, habitatin e tyre, i cili është përshtatur në mënyrë të përkryer për to dhe natyrën përreth fermës. Kutitë e informacionit (info-box) japin mundësinë për t'u zhytur në botën e dhive duke u informuar në detaj dhe për të parë nga afër përpunimin e qumështit bio të dhisë në një gamë të shijshme krem djathi dhe.

Të gjitha specialitetet e djathit të dhisë dhe shumë produkte rajonale mund të blihen në dyqanin e fermës. Gama "delicate" e djathit të dhisë mund të shijohet gjithashtu në dyqanin e fermës. Vizitorët mund të pushojnë në tarracë duke parë dhitë në murin e gurtë dhe duke shijuar peizazhin e bukur.

www.ziegenhof.at

Për më shumë informacion:



QF
PB Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al